



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.06.2019 ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 28.05.2019.
2. Miratimi i kalendarit 3- javor të punës së komisionit.
3. Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Elena Xhina, Sadi Vorpsi, Luan Duzha, Luan Harusha, Antoneta Dhima, Elona Hoxha, Edmond Rrushi, Paulin Sterkaj, Lefter Maliqi, Arben Elezi.

Mungojnë:

Xhemal Qefalia, Eljo Hysko, Anduel Xhindi, Ylli Shehu, Myslym Murrizi

Të ftuar:

Erjon Luci- Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë.

Artur Kala - administrator i AAPSK-së.

Gloria Carkaxhiu – specialiste në Sektorin e Studimeve Juridike dhe Analizës Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi!

Hapim mbledhjen e Komisionit të Sigurisë.

Sikurse jeni njoftuar, në rendin e ditës kemi miratimin e kalendarit 3-javor, pra puna që do të bëhet në komisione dhe në seancë plenare gjatë muajit qershor; miratimin e procesverbalit të datës 28 maj; shqyrtimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”. Janë disa nene që neve na kanë mbetur pa diskutuar dhe, natyrisht, nuk i janë nënshtruar votimit në komision. Gjithashtu, pasi të mbarojmë Kodin Penal, do të kemi shqyrtimin në parim të projektligjit “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”. Është një kalendar disi i ngjeshur, sepse janë një paketë projektligjesh që ne jemi të detyruar, edhe për shkak të mekanizmit Manival, t’i referojmë si ndryshime të këtyre projektligjeve, por që natyrisht do të duhet t’i kalojmë në komisionin tonë dhe në komisionet e tjera parlamentare para se t’i votojmë në seancë.

A keni vërejtje për rendin e ditës?

Miratohet.

Ndërkohë, më lejoni t’i uroj suksese në detyrën si sekretare në Komisionin e Sigurisë Kombëtare, zonjës Antoneta Dhima!

Nga kolegët propozues për ndryshime në Kodin Penal kemi zotin Shameti me të cilin do të vazhdojmë diskutimin nen për nen të ndryshimeve të mësipërme.

Fjala për zotin Maliqi.

Lifter Maliqi – Faktikisht u bë hera e tretë që unë diskutoj për ndryshimet në Kodin Penal, por që herën e parë kam thënë që këto ndryshime duheshin bërë vite më parë, nuk ka sesns që ne po nxitojmë të çojmë në parlament në datën 13 këto ndryshime, ndërkohë që kemi një krizë të madhe politike, ndërkohë që ju jeni në fushatë me veten, pra deputetët e PS-së bëjnë fushatë me veten, deputetët e tjerë të opozitës nuk e di me kë do të bëjnë fushatë, mbase të gjithë së bashku do të shkojnë te Hazbiu në Leskovik, se ç’është atje një kandidat i famshëm, sepse kështu po bëhen këto zgjedhje. Kështu që unë jam kundër veprimeve të shpejta dhe kundër presioneve që po i bëhen opozitës.

Situata nuk është e qetë për shqiptarët. Nuk mund të ketë zgjedhje pa opozitën. Harrojeni! Edhe po pati, do të jenë të cunguara, do të shtyhen. Harxhoni lekë, bëni presione se do të mbyllen

rrugët e Europës dhe Amerikës, se do të arrestohen njerëz e të tjera, por nuk mund të futet një opozitë e tëra në burg dhe nuk mund të kalojë vendi në diktaturë, prandaj shpejtimi i miratimit të ndryshimit të këtyre neneve të Kodit Penal është për të bërë një presion tjetër psikologjik. Sa më shumë presion psikologjik të bëni, aq më keq është. Unë po bëj sot një thirrje publike që Rama të ulë ironinë dhe arrogancën ndaj opozitës, drejtuesit e opozitës të ulin tensionet, Presidenti i Republikës të ndërhyjë për të ulur palët në dialog dhe ndërkombëtarët të arrijnë në marrëveshje, sepse do të ketë pasoja të mëdha nëse do të ndodhë gjë në datën 30 qershor. Ju e dini shumë mirë që edhe me polici nuk mund ta menaxhoni dot situatën. Edhe pse në çdo qendër votimi do të keni një polic, në qark do të keni 1-3 grupe të gatshme, situata mund të precipitohet në disa qendra votimi ose në të gjithë Shqipërinë. Këto janë presione, matje force, ironi, shantazhe. Unë mendoj se situata duhet të qetësohet, por të mos e nxisim më shumë me këto ndryshime në Kodin Penal për t'i parandaluar njerëzit. Jam dakord që të gjendet një gjuhë e përbashkët, kushtet e opozitës të jenë më të lehta, pra jam për uljen e tensioneve dhe jo për nxitjen tyre. Isha në Berat, isha në Kuçovë, qeshin, sepse edhe socialistët thonë që këto nuk janë zgjedhje. Unë them ta shtyni këtë gjë, sepse nuk mund ta çojmë vendin në përplasje dhe diktaturë.

Ermonela Felaj- Ndërhyrja për procedurë nuk duhet të bëhet kaq e gjatë.

Kodi Penal ka disa javë që diskutohet në Kuvendin e Shqipërisë. Në komisionin tonë jemi në javën e tretë, pra është mbledhja e tretë, edhe pse nuk është komision përgjegjës, ndërkohë janë të angazhuara të paktën 4 komisione parlamentare sipas natyrës së ndryshimeve të sjella që janë duke punuar me Kodin Penal. Kështu që nuk ka asnjë arsye për të nënkuptuar që ne po nxitojmë. Ne punën tonë do ta bëjmë. Unë do t'ju thosha juve dhe të gjithë kolegëve të mos ia qajmë hallin kalorësit që i varen këmbët. Zgjedhjet do të bëhen në datën 30 qershor dhe pikë.

Lefter Maliqi – Nuk jam kundër kësaj.

Ermonela Felaj - Mos ndërhyini pa leje! Mbledhja ka një drejtues!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lefter Maliqi – Lëre kalorësin, se kemi parë kalorës që i janë thyer këmbët dhe brinjët. Do t'ju thyhen edhe juve brinjët.

Ermonela Felaj - Zoti Maliqi, nëse ju nuk ju pëlqen mund të vazhdoni, ne kemi qëndrimin tonë dhe nuk ju marrim dorën juve.

Lefter Maliqi – Kalorësi, kur vete në betejë, nuk lufton me veten, lufton me të tjerët.

Ermonela Felaj – Lërimi tani këto!

Kemi mbetur në diskutimin e nenit 15.

Adnor Shameti- Fillojmë me nenin 15, sepse nenin 14 e kemi përfunduar.

Ermonela Felaj- Neni 15 bën fjalë për një shtesë pas nenit 274, që është neni për prishjen e rendit dhe të qetësisë, pra shtohen dy nene të reja, “Goditja e sportistit, trajnerit, arbitrit dhe ndërmjetësit sportiv”, neni 274/a dhe neni 274/b “Veprimet e dhunshme në ambientet sportive”. Këto janë dy nene që edhe nga ajo që është bërë publike, nga gjithë komuniteti sportiv, le të themi, janë propozuar ose janë përcjellë si nevojë që të reflektoheshin në Kodin Penal.

Unë mendoj se është momenti i duhur që ne ta bëjmë këtë duke marrë shkas nga të gjitha ngjarjet e papëlqyeshme që kanë ndodhur në aktivitete të ndryshme sportive duke u vendosur edhe në rrezik jeta dhe shëndeti i protagonistëve të këtyre aktiviteteve sportive.

Si relator për nenin 274/a unë kam këto sugjerime: së pari, nuk e di nëse “ndërmjetës sportiv” është e përkufizuar diku, nëse nuk është e përkufizuar diku në ligj, do të thosha që ky term të mos përdoret, sepse përdoruesve të Kodit do t’iu krijonte diskutim; së dyti vërej që në mes të paragrafit të parë dhe të dytë ruhet e njëjta masë dënimi sa i takon minimumit. Pra, të godasësh sportistin, arbitrin, trajnerin e të tjerë propozohet që të dënohet me burgim nga 1 deri në 3 vjet, ndërsa në paragrafin e dytë, kur kjo vepër bëhet më e rëndë, sepse cilësohet kur kryhet në ambiente sportive më shumë se një herë ose janë drejtuesit dhe anëtarët e grupeve sportive ata që e kryejnë këtë vepër, dënimi është nga 1 deri në 5 vjet burg. Pra, si në paragrafin e parë dhe të dytin minimumi është i njëjtë, por unë nuk do të isha që minimumi i dënimit të jetë i njëjtë për veprime që nuk janë të barabarta në rëndësinë tyre, kështu që do t’ju propozoja dhe nëpërmjet jush edhe kolegëve të Komisionit të Ligjeve që të hiqet dënimi 1 vit si minimum dënimi në paragrafin e parë dhe të thuhet me burgim deri në 3 vjet. Pra, të fillojë nga minimumi i dënimit me burgim që është 5 ditë.

Adnor Shameti - Faleminderit!

Në lidhje me sugjerimet tuaja të drejta, dua të sqaroj që sa i takon definicionit që bëhet për ndërmjetësin sportiv, është një çështje që i takon teknikës legislative, pra thelbi i dispozitës mbetet i njëjtë dhe nuk ka probleme.

Në analizë të fundit, në diskutimin që do të bëjmë në Komisionin e Ligjeve do të shikojmë përputhshmërinë e këtij termi me ligjin për sportin në Republikën e Shqipërisë, se si është i shprehur, është ndërmjetës sportiv, a quhet prokurator, siç quhet rëndom gjithandej, pra është fjala për përfaqësuesit ligjorë të sportistëve apo të trajnerëve dhe do të përcaktojmë termin e

duhur. Kjo është çështje që i takon teknikës legislative dhe jo thelbit të dispozitës, kështu që së bashku me sugjerimet tuaja do t'ia përcjellim Komisionit të Ligjeve për të rakorduar termin e duhur, që të ketë të njëjtën gjuhë me ligjin për sportin në Republikën e Shqipërisë.

Sa i takon çështjes së dytë, më duket me vend sugjerimi juaj që të ketë edhe një ndarje midis paragrafit të parë dhe të dytë. Unë nuk shikoj asnjë problem në këtë kuptim. Kështu që edhe kjo ngelet që t'ia përcjellim Komisionit të Ligjeve sipas formulimit që sugjeruat.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Shameti!

Ka ndonjë ndërhyrje nga kolegët?

Po, zoti Sterkaj.

Paulin Sterkaj – Ka dy paragrafë në këtë projektligj, njëri dënon, tjetri dënon akoma më shumë. Po puna parandaluese ku është? Pra, nëse bëhet fjalë për një person e përsërit një ose më shumë herë, atë nuk duhet ta lëmë të shkojë në stadium. Ka praktika ndërkombëtare që individë të caktuar që shkelin rregullat dhe ligjin në arenat sportive dënohen me mospjesëmarrjen. Ka ligje që nuk e lejojnë personin të hyjë në lokal dhe, po e bëri këtë, ai merr një masë dënimi. Pse duhet të themi po shkoi edhe herën e dytë, po e përsëriti (ai mund të jetë prototip i tillë, ai mund të jetë tifoz i sëmure), këtij personi duhet t'i ndalohet hyrja në stadium.

Ka praktika angleze për personat që bëjnë shkelje dhe përdorin dhunë në stadione, të cilëve u ndalohet hyrja për iks vjet ose për gjithë jetën. Pse ne duhet të shprehemi që herën e dytë do t'i ndalohet 5 vjet, kur, në fakt, atij duhet t'i bëhet e ndaluar hyrja në atë ambient dhe këtë gjë mund ta parashikojmë në ligj?

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Sterkaj!

Po, zoti Shameti.

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

E vlerësoj sugjerimin e zotit Sterkaj!

Sqarimi i vetëm që dua të bëj është që subjekti është i ndryshëm në dy paragrafët që flasim. Tjetër është subjekti i veprës penale në paragrafin e parë dhe i ndryshëm në paragrafin e dytë. Kështu që sa i takon masës që ju sugjeroni, është masë e elementit administrativ dhe është e përcaktuar në ligjin për sportin, ndërsa këtu po flasim për ndryshimin në Kodin Penal. A do të parashikohet këtu si dënim plotësues apo jo, unë nuk e shikoj me vend, sepse e zgjidh ligji për sportin një element të tillë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Shameti!

Zoti Rrushi, fjala për ju.

Edmond Rrushi – Faleminderit, zonja kryetare!

Vë re diçka, ndërmjet paragrafit të parë dhe të dytë kemi pothuajse të njëjtën gjë. Marrim trajnerët për shembull ose anëtarët e klubeve sportive, në qoftë se nuk e kryejnë brenda ambientit të territorit sportiv, atëherë ai mund ta kryejë jashtë, sepse ka masë dënimi më të lehtë në paragrafin e parë. Këtu thuhet: “goditja për shkak... ose vepra të tjera dhune...”, ai nuk e kryen brenda territorit sportiv, por e kryen jashtë.

Ermonela Felaj – Atëherë, po jap unë një përgjigje për këtë: paragrafi i parë nuk ka të bëjë me vendin ku kryhet, pra mjafton që ti të godasësh një sportist, trajner, arbitër apo një ndërmjetës dhe dënohesh me burgim nga 5 ditë deri në 3 vjet.

Paragrafi i dytë e rëndon dënimin nëse vepra kryhet në mjedise sportive, pra, vendi ku ndodh në këtë rast, është përdorur si rrethanë që e rëndon dënimin, kur kryhet më shumë se një herë, po ashtu është rrethanë rënduese. Kur subjekt i kësaj vepre nuk janë tifozët apo njerëz të tjerë të tretë, por janë drejtuesit dhe anëtarët e klubeve sportive, dënimi bëhet (maksimumi dhe minimumi, në fakt, ndryshojnë), nga 5 ditë, 1 vit, dhe nga 3 vjet, 5 vjet. Pra, rastet janë të gjitha të penalizuara, siç del nga kuptimi i dispozitës.

Në qoftë se nuk ka ndonjë ndërhyrje tjetër, kalojmë në miratimin e tij.

Kush është dakord me nenin 74 me sugjerimet që ndamë së bashku me relatorin?

Miratohet neni 15.

Për nenin 274, germa “b”, kam një ndërhyrje të teknikës legjislative. Ky nen duhet të propozohet si neni 16 në numërtim, pra nuk mundet që të jenë bashkë.

Sa i takon përmbajtjes së dispozitës “Veprime të dhunshme në veprimtaritë sportive”, do të doja të bëja një propozim të tillë: në fjalinë e parë “hedhja e sendeve të forta në fushën e lojës”, të thuhet “hedhja me dashje” që të nënkuptohet që rasti, i cili dënojmë në është ai i hedhjes me dashje të sendeve në fushën e lojës, jo ndonjë rast i ndryshëm.

Sa i takon paragrafit të dytë, do të doja të bëhej një korrigjim nga ana gramatikore, pra “hyrja në fushën e lojës gjatë kohës së zhvillimit të aktivitetit sportiv”, të mos thuhet “nga persona të paautorizuar” por “e personave të paautorizuar”, pra të hiqet parafjala “nga”.

Ndërkohë, paragrafi i tretë duhet të figurojë si paragraf i tretë, jo si një fjali që vazhdon. Pra, nga pikëpamja e konfigurimit të shkrimit të dispozitës, duhet t'i kemi kujdes këto.

Këto janë propozimet e mia. Për pjesën tjetër, unë jam dakord që të gjitha veprimet e dhunshme në aktivitetet sportive, sendet e forta që hidhen në fushë, mbajtja e fishekzjarrëve, flakadanëve, hedhja e tyre, janë veprime që nuk duhet të ndodhin, dhe, nëse ndodhin, duhet të dënohen në masën dhe mënyrën e duhur.

Para se t'jua jap fjalën, zoti Harusha, mund të dëgjojmë edhe një qëndrim nga relatori?

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Të gjitha ndërhyrjet tuaja i konsideroj të drejta, janë çështje që i takojnë teknikës legislative dhe vetëm e përmirësojnë gjuhën e tekstit që paraqitet për miratim. Jam i mendimit që t'ia përcjellim të gjitha Komisionit të Ligjeve dhe së bashku me këshilltarët të bëjmë qoftë renditjen e dispozitave për ta shtuar si dispozitë të re dhe jo si paragraf më vete, qoftë edhe teknikën dhe gjuhën e përdorur për definicionin që sugjeruat.

Kështu që mendoj që sugjerimet tuaja të jenë pjesë e inkorporuar e variantit që do t'i paraqitet Komisionit të Ligjeve.

Faleminderit!

Luan Harusha – Faleminderit, kryetare!

Jam dakord me ndryshimet në këtë projektligj, por kisha diçka tjetër: po në qoftë se një arbitër apo një përfaqësues i arbitrave që ndodhen në fushë, merr një vendim të padrejtë, a mban dikush përgjegjësi? Sepse tifozët janë tifozë dhe nuk mund t'i ndalosh, por, në qoftë se një arbitër merr një vendim të padrejtë, a penalizohet kush?

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Zoti Shameti besoj se e ka një përgjigje për këtë pyetje.

Adnor Shameti – Besoj se jeni në dijeni se, nëse ka një gabim nga autoritetet e drejtimit të një aktiviteti sportiv, që janë arbitra, përgjegjësia është disiplinore nga trupa që rregullon secilën federatë. Nëse pastaj provohet që ka një veprimtari me dashje për shkak të marrjes së të hollave në këmbim të një favorit apo gjë tjetër, atëherë është tjetër problem.

Sot është futur teknologjia në të gjitha sportet dhe është e thjeshtë të verifikohet çdo gjë duke kthyer sekuenat mbrapsht. Pra, duhet ndarë përgjegjësia disiplinore që përcaktohet dhe pastaj do të rregullohet. Nëse ka përgjegjësi penale që ai është i korruptuar, është tjetër dispozitë dhe tjetër çështje.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Pra, korrupsioni është i dënueshëm nga kushdo që e kryhen.

Luan Harusha - Në qoftë se ai person dënohet dhe për këtë arsye ai penalizohet me një gjobë administrative, a të duket e drejtë kjo?

Ermonela Felaj – Po, zoti Shameti.

Adnor Shameti - Marrëdhënien e trupës, që drejton aktivitetin sportiv me federatën përkatëse për marrëdhëniet disiplinore e rregullojnë autoritetet përkatëse, kurse, nëse do të provohet që ka një element penal në këtë keqadministrim të një aktiviteti sportiv, atëherë është vepër penale dhe rregullohet nga Kodi Penal, por nuk është pjesë e kësaj dispozite që ne kemi inkorporuar.

Faleminderit!

Luan Harusha – Unë mendoj që më parë duhet të ishte bërë ligji për arbitrat e më pas për tifozët.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Zoti Harusha, jemi te Kodi Penal. Të gjitha sjelljet sportive rregullohen me ligjin e posaçëm dhe në momentin që këto sjellje janë në kundërshtim me ligjin dhe kryhen me faj, ato bien nën Kodin Penal dhe do të dënohen nga Kodi Penal. Rasti që ju ngritët nuk është rast që e parashikon Kodi Penal, por një vendim i padrejtë i marrë nën korrupsion nga ana e arbitrit, nuk mund të shërbejë si justifikim për tifozët, që ata të kryejnë vendime të dhunshme, sepse këto veprime duhet të dënohen në çdo rast dhe ky është kuptimi i kësaj dispozite, kështu që ai do të mbajë përgjegjësi për shkeljet që ka bërë në rast se ajo është shkelje penale.

Pra, ne duhet të bëjmë një diferencë të qartë midis asaj që duhet dhe mund të përmbajë Kodi Penal dhe ato që përmbajnë ligjet e tjera, sepse jo çdo lloj shkeljeje që ne mund të amendojmë, që është në kundërshtim me ligjin dhe me moralin, është penale, por kjo që ne jemi duke propozuar duam ta bëjmë shkelje penale.

Nëse ti i bën të gjitha këto veprime të dhunshme gjatë kohës që zhvillohet një aktivitet sportiv, hedh zjarr, hedh kapsolla, godet, siç ka ndodhur që janë goditur në fushë arbitri dhe sportistët e të tjera me radhë, janë sjellje të dënueshme.

Luan Harusha – Në shumicën e rasteve, nga ato që kemi parë në televizion, 90% e problematikave prej arbitrave janë shkakuar. Një vendim i padrejtë i arbitrit mund të shkaktojë rrëmujë dhe përplasje të tifozëve me lojtarët.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Unë besoj se gjykatat dhe prokuroritë, siç e kanë detyrimin, duhet ta mbajnë këtë gjë parasysh në zbatimin e masës së dënimit, për të kuptuar nëse ka qenë një sjellje e provokuar apo e qëllimshme. Hapësira në këtë rast është, sepse flasim për dënime që nisin nga një minimum dënimi dhe kanë një diapazon jo të vogël, prandaj është mundësia për ta vlerësuar atë që ju keni merak.

Fjalën e ka zonja Duka.

Elena Xhina Duka - Faleminderit, zonja kryetare!

Sa i takon dispozitës në pjesën e dytë të saj, hyrjes në fushën e lojës, do të kërkoja që veprimet e subjekteve të lidheshin me pasojën, ndërsa këtu nuk e shohim të lidhet me pasojën. Propozimi që unë kam është që dispozita të riformulohet në këtë mënyrë: “Hyrja në fushën e lojës gjatë kohës së zhvillimit të aktivitetit sportiv nga persona të paautorizuar, që shkakton pengimin e zhvillimit normal të aktivitetit sportiv”. Kjo është ajo që unë doja të propozoja, sepse, po ta linim pa një pasojë, pra vetëm hyrja në fushën e lojës pa sjellë asnjë pasojë, as pengim të aktivitetit, do të ishte shumë më e gjerë dhe për mua do të penalizonte një fushë të gjerë subjektesh.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Me cilën pasojë ta lidhim?

(Diskutime pa mikrofon)

Propozimi i zonjës Elena është: “Hyrja në fushën e lojës gjatë zhvillimit të aktivitetit sportiv e personave të paautorizuar, që sjell pengimin e zhvillimit normal të aktivitetit sportiv dënohet me burgim nga 1 deri 3 vjet”.

(Diskutime pa mikrofon)

Kjo është thjesht për t’u futur...

(Diskutime pa mikrofon.)

Do të dëgjojmë fillimisht qëndrimin e relatorit, pasi u bënë disa propozime, dhe më pas e hedhim në votim.

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Duke qëndruar në të njëjtën linjë me sugjerimin tuaj për nenin 15, do t’i propozoja Komisionit të Ligjeve që përcaktimi të jetë siç është këtu me lidhëzën “ose”. Pra, “Hyrja ...ose pengimi...” me ndryshimin që në fjalinë e parë të themi: “...dënohet deri në 3 vjet”, kurse pjesa tjetër të jetë e përcaktuar “...për aktivitete ndërkombëtare” dhe mund ta ndajmë në dy paragrafë.

Paragrafi i parë të jetë: “...të ketë dënim deri në 3 vjet. Pra, minimumi të jetë 5 ditë, që do të thotë se vetëm, nëse futesh aty do të dënohesh, por nuk duhet ta lemë minimumi 1 vit, sepse më duket masë e ashpër.

Paragrafi i dytë të jetë: “...pengimi”, dhe paragrafi i tretë të jetë: “...aktivitetit ndërkombëtare”. Kjo të bëhet edhe për teknikë legjislative. Në të njëjtën mënyrë do të ruhej mënyra e referimit dhe e paraqitjes në dispozitat paraardhëse.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – A ka komente nga kolegët e tjerë për këtë nen? Nga fakti që nuk ka komente, nënkuptoj se jeni dakord me të gjitha komentet që u bënë.

Atëherë, kalojmë në votim e nenit 274/b me të gjitha vërejtjet e bëra për këtë nen. Në fakt, në tekstin e draftit ky nen do të konfigurohet si neni 16 i projektligjit.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 16, që për teknikë legjislative duhet të numërohet si neni 17. Ministria e Brendshme, te drafti i propozuar nga deputetët ka propozuar një ndryshim në nenin 278 të Kodit Penal, që bën fjalë për armëmbajtjen pa leje.

Unë vë re se është ndryshuar masa minimale e dënimit për mbajtjen e armëve, armëve shpërthyesë ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet të motorizuar në mjediset publike ose mjediset e hapura. Pra, masa e dënimit ka qenë 3 deri në 7 vjet dhe propozohet të jetë 5 deri në 7 vjet. Pra, rritet minimumi i masës së dënimit. Ndërkohë, menjëherë pas këtij paragrafi shtohet edhe një paragraf tjetër, i cili e rëndon dënimin, në rast se nga mbajtja e armëve pa leje, ashtu sikundër e përmenda, kanë ardhur pasoja të rënda. Pra, këtu thuhet: “Kur kjo vepër kryhet më shumë se një herë apo sjell pasoja të rënda, të dënohet me burgim nga 7 deri në 15 vjet”.

Në fakt, unë nuk kam ndonjë vërejtje të veçantë për këtë nen, por do të doja ta diskutoja me ju, kolegë, nëse diapazoni i dënimit 5 deri në 7 vjet është diapazoni i duhur. Ndoshta do të ishte më mirë që të bënim një rritje të minimumit të dënimit. A do të ishte një mundësi më e gjerë vlerësimi për gjykatën masa e dënimit 4 deri në 7 vjet? Këtë pyetje e kam për relatorin, sepse më duket shumë e afërt masa e dënimit 5 deri në 7 vjet.

Adnor Shameti – Për mendimin tim, varianti i paraqitur i përgjigjet proporcionalitetit të veprës. Gjithsesi, nëse do të ketë ndonjë sugjerim nga ana e kolegëve të komisionit, jemi të hapur që ta diskutojmë në variantin përfundimtar në Komisionin e Ligjeve.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – A ka ndonjë ndërhyrje nga ana juaj, zoti Paulin?

Paulin Sterkaj – Unë jam i mendimit se Kodi Penal është në rregull, në qoftë se zbatohet. Pra, nuk rregullon asgjë, nëse rritet masa e dënimit, përveçse rritet masa e korrupsionit. Unë nuk jam për dënime të ashpra, por jam për politika të tjera lidhur me armatimin dhe çarmatosjen e popullsisë. Nuk ka faj populli që ka një armë në shtëpi; nuk ka faj populli kur dikush bën vetëgjyqësi; nuk ka faj populli kur një njeri shkon të marrë një vërtetim pronësie dhe nuk ia japin; nuk ka faj populli kur dikush del për të grabitur dhe nuk ka prezencë policie për ta mbrojtur.

Prandaj, problemi është se duhet të bëhen politika të tjera për çarmatosjen e popullsisë. Me rritjen e masës së dënimit, nuk është se i kemi zgjidhur të gjitha, sepse ne nuk kemi asnjë përgjegjësi për të rritur masën e dënimit, por kemi përgjegjësi për të marrë pasa parandaluese dhe për të gjetur forma dhe mënyra sociale, në mënyrë që ta detyrojmë popullsinë të dorëzojë armatimin që ka në shtëpi. Armatosja e popullsisë ka ardhur si rezultat i politikave të këqija në vitin 1997, sepse shteti nuk i ka mbrojtur depot e armatimit. Sot me dashje apo pa dashje gjithkush mund të ketë një armë në shtëpi. Ndoshta rastësisht mund të ndodhë që një fëmijë të gjejë një armë në shtëpi dhe mund t'i duket si lodër. Atëherë, i bie që ta dënojmë ne këtë fëmijë?!

Prandaj, unë nuk mendoj se rritja e masës së dënimit është e vetmja që rregullon sigurinë publike, duke i dënuar njerëzit me burg. Pra, do të ishte shumë më mirë që të gjejmë forma dhe mënyra të tjera, të cilat i kemi diskutuar edhe herë të tjera; duhet të bëjmë politika sociale në këtë pikëpamje. Unë nuk jam dakord që të rrisim masën e dënimit, sepse, edhe nëse e bëjmë, nuk do të thotë se i kemi kryer detyrimet që kemi ndaj popullit. Asgjë nuk bëjmë me këtë.

Për të ulur masën e dënimit, ne duhet të gjejmë forma të tjera sociale. Unë nuk e kuptoj pse është krijuar kjo frymë në Kodin Penal për të dënuar njerëz dhe për të rritur masën e dënimit?! Ka shumë njerëz, të cilët janë kapur me armë pa leje dhe nuk kanë marrë as minimumin e dënimit, por kanë dalë në kushte të tjera dhe vazhdojnë jetën normalisht në shtëpitë e tyre. Unë mendoj se duhet ta klasifikojmë ndryshe, sepse një njeri mund ta ketë armën dhe nuk përbën asnjë problem. A duhet të bëjë 5 vjet burg ky njeri?! Nuk është kusht që të themi 5 deri në 15 vjet burg.

Ermonela Felaj –Në fakt, unë po bëj një verifikim të vogël dhe duhet që këtu të bëjmë një ndërhyrje. Në këtë nen, pra që bën fjalë për armëmbajtjen pa leje, është ndërhyrë disa herë në Kodin Penal. Kjo është pak, por e sigurt.

Paulin Sterkaj – Nuk ka rregulluar asgjë deri më sot.

Ermonela Felaj – Nuk ka rregulluar asgjë, për shkak se nuk është arritur të ndërtohet një politikë e unifikuar në shkallë vendi, ose është bërë në mënyrë të njëanshme. Ka qenë një periudhë kohe, kur Prokuroria e Përgjithshme i urdhëroi të gjitha prokuroritë në vend për masën e dënimit për armëmbajtjen pa leje. Pavarësisht se në atë kohë masa minimale ishte me gjobë ose burgim deri në 7 vjet, të gjithë prokurorët detyroheshin sipas një urdhri, që, në gjykimin tim, ka qenë i drejtë për kohën, të kërkonin masa dënimi që shkonin jo më pak se 3 vjet burg. Kjo ishte masa minimale dhe prokurorët ishin të detyruar të mos kërkonin një masë më të ulët dënimi. Një gjë e tillë u kërkua për të arritur maksimumin e efektivitetit të zbatimit të ligjit për sa i takon kësaj vepr penale. Për hir të së vërtetës, nuk ka qenë e njëjta përgjigje nga gjykatat, sepse ato kanë ruajtur një qëndrim të ndryshëm nga ajo që është kërkuar nga prokuroria. Ndërkohë, më duhet të konstatoj diçka tjetër, sepse e kemi ngritur si problem, por rasti e sjell që ta reflektojmë edhe këtu.

Ne shpeshherë vuajmë nga mungesa e botimit të teksteve të konsoliduara të ligjit dhe ky është një nen, i cili është ndryshuar disa herë, ka ndërhyrë edhe Gjykata Kushtetuese për përmbajtjen e nenit 278. Unë shikoj se paragrafi, ku kërkohet të bëhet ndryshimi, jo vetëm që nuk është paragrafi i parë, sepse në tekstin e draftit thuhet: “Paragrafi i parë i nenit 278 ndryshohet”, por ky nuk është fare paragrafi i parë, por është paragrafi i pestë i ligjit, i cili aktualisht është e rënduar dhe janë parashikuar edhe rrethanat e cilësuar.

Unë po e lexoj Kodin e ri Penal: “Mbajtja e armëve, bombave apo minave, lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar në mjediset publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga 7 deri në 15 vjet”. Pra, dënimi është nga 7 deri në 15 vjet për këtë vepër. Me sa duket, është referuar gabim, sepse dënimi 3 deri në 7 vjet është ndryshuar dhe kemi kaluar në një masë maksimale dënimi, që nuk është as kjo që kemi ne para, por është 7 deri në 15 vjet.

Në paragrafin e fundit thuhet: “Kur vepra kryhet në sasi të mëdha në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga 5 deri në 15 vjet”. Pra, gjykoj se ndryshimet janë bërë, referenca ka qenë e gabuar, sepse kanë konsultuar një variant jo të përditësuar të këtij neni. Më duket se nuk kemi pse të vijojmë të diskutojmë për nenin 278. Do t'i sugjeroja Komisionit të Ligjeve të bënte të njëjtin konfirmim. Unë e kam Kodin përpara dhe për sa kohë dispozita është kështu, është në rregull.

Adnor Shameti - Faleminderit!

Të gjitha sugjerimet tuaja do t'ia përcjellim Komisionit të Ligjeve që të kemi një gjuhë të unifikuar në variantin përfundimtar.

Dua të sqaroj edhe një gjë tjetër, që i përgjigjet edhe shqetësimit të ligjshëm, të drejtë të zotit Sterkaj, ashtu sikurse ju me të drejtë e përmendët në fjalën tuaj se Prokurori i Përgjithshëm me urdhra dhe udhëzime orienton politikën penale që do të ndiqet për secilën veprë penale apo grup veprash penale, duke e parë në vijimësi, ka një mospërputhje midis asaj që parashikon Kodi Penal dhe zbatimit në praktikë të kësaj dispozite.

Ajo që parashikohet në paragrafin e parë se dënimi në minimum të jetë 5 vjet, duke parë edhe aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, bën të mundur që Prokurori i Përgjithshëm me një udhëzim të thotë: “Për të gjithë ata persona që akuzohen apo do të dënohen për nenin 278 të Kodit Penal “Mbajtjen e armëve luftarake pa leje”, të mos aplikohet neni 59 në asnjë rast, sepse e kalon kufirin minimal për t'u aplikuar”. Kjo politikë shtrënguese do të bëjë që të marrë masa gjithsecili, pra ta mendojë mirë para se të bëjë një veprim të tillë, vetëm për ta mbajtur atë dhe jo më për paragrafët e tjerë kur situata është e qartë dhe i përgjigjet rëndësisë së veprës dhe proporcionalitetit të saj.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Besoj se nuk kemi çfarë të miratojmë te neni 16, vetëm nëse miratojmë ndërhyrjen tonë duhet të shikohet në botimin zyrtar me qëllim që nëse është kështu siç e kemi në tekstet e përditësuar nuk ka nevojë të reflektohet asnjë ndryshim, përndryshe duhet që ju ta diskutoni atje.

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina - Dua të shtoj faktin se është një vendim i Gjykatës Kushtetuese i vitit 2016 që ka shfuqizuar paragrafët 5 dhe 6 të Kodit Penal lidhur me dispozitat që ju referuat. Kjo besoj se duhet t'i përcillet Komisionit të Ligjeve për të parë tekstin integral dhe atë aktual. Kjo duhet t'i referohet edhe grupit të deputetëve nismëtarë.

Ermonela Felaj - I vetmi verifikim është ai me botimin zyrtar. Botimi që kam unë është i fundit dhe e referon vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Dyshoj fort se varianti që i janë referuar propozuesit ka qenë varianti jo i përditësuar. Ndërkohë është përcjellë ndryshimi.

Për vërejtjet që u bënë në raport me nenin e propozuar, që do të reflektohet si neni 17 i projektligjit, jeni dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te një nen tjetër që është propozuar t'i shtohet Kodit Penal. Është neni 278, germa “b””: “Prodhimi, mbajtja, tregtimi i armëve bërthamore nukleare ose kimike”.

Zoti Shameti, kam vetëm diçka: fjalët “armë bërthamore” dhe “armë nukleare” më duken e njëjta gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të doja të hiqej fjala “nukleare”. Nuk kam vërejtje për nenin, besoj se është një nen që i duhet Kodit Penal. E vetmja lloj arme që nuk është parashikuar në Kodin Penal si armëmbajtje që dënohet është ajo e armëve radioaktive.

Kush është dakord me nenin 17 që reflektohet si neni 18? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18, bën një ndërhyrje jo thelbësore në mënyrën sesi është shkruar neni 282, që është neni ekzistues i Kodit Penal, është neni “Për shkeljen e rregullave për lëndën plasëse, djegëse dhe radioaktive”.

Në fakt, do të doja një shpjegim: pse është hequr fjala “radioaktive”, sepse pak më lart sapo propozuam një nen për armët bërthamore, nukleare dhe kimike? Po në këtë rast pse është ndërhyrë te neni 282, nëse gjithmonë e keni këtë shpjegim, pse është hequr fjala “substancia radioaktive”? Substancat radioaktive janë e njëjta gjë me lëndët plasëse dhe djegëse? Mendoj se shpjegimi në këtë rast do të ishte nga dikush që është teknik në këtë fushë se çfarë është pasur parasysh që është kërkuar ky ndryshim.

Adnor Shameti – Mendoj se kjo gjë ka gjetur rregullim në paragrafin më përpara, që diskutuam dhe nuk ka kuptim që të përsëritet. Ky është sqarimi racional.

Ermonela Felaj – Po shikoj një gjë, në nenin që miratuam pak më parë dënohet: “Prodhimi, mbajtja dhe tregtimi”, ndërsa te neni aktual që u referohet edhe atyre radioaktive ka më shumë veprime, sepse thotë: “Shkelja e rregullave për mbajtjen, për prodhimin, për përdorimin, për ruajtjen, për transportimin, për shitjen” përbën këtë gjë. Nëse ju mendoni se i kemi ndarë veçmas...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atje është përdorur “armë bërthamore” nuk është përdorur “substancia radioaktive”, përsëri kam një dyshim për këtë gjë.

Nuk e di, zoti Duzhaj, a na ndihmoni dot me këtë shpjegim? A ka një dallim midis lëndëve plasëse, djegëse dhe radioaktive? Po i referohem *background*-it tuaj, pasi keni punuar në një uzinë ushtarake.

Luan Duzha - Lëndët plasëse janë lëndë të cilat prodhohen vetëm për mbushjen e armëve dhe të municioneve, kurse lëndët radioaktive janë tjetër gjë, nuk kanë lidhje me lëndët plasëse.

Ermonela Felaj - Faleminderit zoti Duzha për ndërhyrjen tuaj!

Zoti Shametaj, në fakt duhet ta verifikojmë këtë nen, të shikojmë pse ka ardhur ky ndryshim. Ne nuk po votojmë për këtë nen, sepse nuk kemi një qëndrim të qartë nga kolegët.

Paulin Sterkaj - Radioaktiviteti mund të vijë në disa forma: me ushqime, me materiale ndërtimi dhe me materiale industriale, prandaj duhet të parashikohet.

Ermonela Felaj - Po, por ligji e dënon deri tani mbajtjen e substancave radioaktive. Duke e hequr ne nuk e dënojmë dot.

I njëjti problem është dhe me nenin që pason, Edhe te neni 19, te neni 282, germa “b” është parashikuar të hiqet edhe nga titulli, edhe nga përmbajtja fjala “radioaktive”. Është e njëjta gjë për të cilën nuk kemi një sqarim, pse është kërkuar ky ndryshim në këto nene.

Për sa kohë nuk kemi një sqarim për këtë pjesë, do t’ju lutemi kolegëve të Komisionit të Ligjeve që ta sqaroni me personat përkatës.

Kalojmë te neni 20, në grupin e neneve që janë propozuar si ndryshime në lidhje me atë që konsiderohet si siguria ushqimore. Kjo gjë ka munguar në Kodin Penal.

Adnor Shameti - Zonja kryetare, për procedurë?

Ermonela Felaj - Po.

Adnor Shameti - Për sqarim, nuk mund ta lëmë të hapur, që nuk e votojmë, sepse na pengon për miratimin në tërësi. Ne mund të themi: rekomandojmë Komisionin e Ligjeve që ta heqë fare si nen. Votojmë heqjen dhe vazhdojmë me të tjerat që të mos kemi pengesë për votimin.

Ermonela Felaj - Dakord.

Faleminderit për sugjerimin!

Propozimin po e bëj në këtë mënyrë: kush është dakord me miratimin e diskutimeve që bëme për nenin 18, i cili konfigurohet sipas ndryshimeve si neni 19? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E njëjta gjë vlen edhe për nenin që pason. Kush është dakord me vërejtjet që kishim për nenin 19 që konfigurohet si neni 20? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te “Siguria ushqimore”.

Neni 1 që propozohet, është ndryshim i nenit ekzistues: “Prodhimi dhe shitja e ushqimeve dhe lëndëve të tjera të rrezikshme për shëndetin”.

Neni është ndërtuar me disa paragrafë, duke synuar të përfshijë të gjithë gamën e veprimeve, të cilat mund të na bëjnë të binim në riskun e përdorimit të ushqimeve të rrezikshme për jetën dhe shëndetin tonë.

Në fakt, në lidhje me këtë nen, unë nuk kam veçuar ndonjë vërejtje. Nuk e di nëse kolegët kanë ndonjë vërejtje.

Po, zoti Harusha.

Luan Harusha – Faleminderit, kryetare!

Ky nen më duket pak si... Derisa thamë se duhet t’i fusim në burg sportistët, ky nen më duket shumë i lehtë. Zero deri në tre vjet, për herë të parë. Po ky mund të shkaktojë dëme më shumë se sa një tifoz, kështu që duhet penalizuar më shumë, duhet të jetë më i ashpër.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Në fakt, te paragrafi i parë është thjesht të hedhësh në qarkullim një ushqim, një pije, një lëndë ushqimore. Pra, vetëm kjo dënohet. Tek pasojat vijmë më vonë. Se çfarë pasojash ka sjellë, në lidhje me këtë dënohet më rëndë.

Luan Harusha – Për herë të parë, ky e ka zero deri në tre vjet.

Ermonela Felaj – Nuk është zero ajo, por janë pesë ditë.

Luan Harusha – Pesë ditë deri në tre vjet. Për t’u pasuruar, ai mund të rrezikojë të bëjë tre vjet burg.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Mirë, po rastin kur i vjen rreziku personit, e kemi te paragrafi më poshtë. Pra, neni është ndërtuar në mënyrë të përshkallëzuar. Mjafton vetëm veprimi i parë, që ti e hedh në qarkullim dhe unë të dënoj, pa pritur të vijë asnjë pasojë. Neni i parë nuk kërkon pasojë fare.

Luan Harusha – Kryetare, unë të kuptoj ty, por ai mundet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Dakord! Ai është diskutim tjetër.

Pra, ka një propozim për ndryshimin e dënimit në paragrafin e parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kuptova. Jo për herën e parë, po për paragrafin e parë.

Fjalën e ka zoti Shameti. Pastaj, zoti

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Duke mirëkuptuar sugjerimin e kolegut Harusha, dua të them se shqetësimi i zotit Harusha gjen sqarim në paragrafë të tjerë të dispozitës. Që të jemi të qartë, deri më sot kemi qenë në kushtet e një kundërvajtjeje administrative, dhe kjo ka sjellë domosdoshmërinë e ndërhyrjes, për të garantuar sigurinë ushqimore për të gjithë njerëzit, për të gjithë konsumatorët, por kjo do të vijë e shkallëzuar. Pra, nga paragrafi në paragraf përcaktohet rëndësia e shkeljes, përveç asaj që ishte administrative deri më sot, dhe në bazë të pasojës përcaktohet edhe sanksioni.

Jam i bindur se ndarja e paragrafëve bëhet sipas rëndësisë së veprës, sipas shkeljes së bërë nga kundërvajtësi.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Shameti! Dua vetëm të bëj një sqarim, edhe për të gjithë propozuesit: është e mira që ne t’i evidentojmë ndryshimet, si ndryshime që janë të vërteta, jo duke ndryshuar rendin e fjalëve, atë që është e dyta ta vendosim të parën, e anasjelltas, dhe këtë ta quajmë ndryshim.

Jam duke e parë nenin 288 si e kemi ne aktualisht, që nga viti 1995, dhe është i njëjti formulim. Thuhet: “Prodhimi, importimi, ruajtja, shitja e ushqimeve, pijeve dhe lëndëve të tjera” e me radhë. Ndërkohë, këtu fillon: “Importim, prodhim..” Janë shtuar vetëm fjalët: ofrimi për shitje. Gjëja që ne kemi reflektuar aktualisht, është kjo: që në qoftë se neni aktual të dënonte vetëm kur vinte një pasojë e rëndë, me vdekje ose dëmtim të rëndë të shëndetit, me propozimin që ka ardhur, që unë do të doja që në pjesën e parë formulimi të ngelej si aktual, duke u hequr kjo pjesa e pasojë, dënimi ka qenë me gjobë ose burg deri në dhjetë vjet.

E shikoni që edhe diapazoni ka qenë shumë i gjerë, mundësia për korruptim ka qenë patjetër shumë e gjerë, ndërkohë që propozimi që bëhet për masën e dënimit duket më konstruktiv, sepse nuk kërkon pasoja. Pra, mjafton që ti fusësh në qarkullim këto lëndë, dhe dënohesh. Nuk të kërkon fare pasojë. Të penalizon që në momentin më të parë, pa vajtur fare te konsumatori. Për këtë të dënon vetëm me burgim, dhe masa maksimale e dënimit është tre vjet. ndërkohë, kur ulet

në dy paragrafët e tjerë, të thotë se po e kreve këtë gjë në bashkëpunim, po e kreve më shumë se një herë, po e kreve edhe për herë të parë, po me herën e parë të ka vdekur një person, ose është sëmurrur shumë rëndë, për këtë të dënoj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po mundohem ta shpjegoj, të lutem!

Të dënoj tre deri në dhjetë vjet. Kur dëmtimi konstatohet jo më tek një njeri, por te disa njerëz, edhe te gratë shtatzëna, edhe te fëmijët, në këtë rast burgimi është maksimal, se shkon dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet burg.

Pra, këtë ka bërë si gjë të re kjo dispozitë, që e heq gjobën, kur kërkon pasojën domosdoshmërisht, siç kërkohej më parë. Edhe nga përvoja ime mund ta them, që sa herë jemi përballur me vepra të tilla, vështirësia kjo ka qenë, sepse nuk verifikohej pasoja. Duke mos u verifikuar pasoja, personi mbetet i padënuar, ndonëse ai mund të hidhte në qarkullim ushqime të kësaj natyre, të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e njerëzve. Tani, me këtë dispozitë ne e shmangim këtë pjesë, që të mund t'i përqendronim diskutimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë do t'ia jap fjalën zotit Elezi, sepse e ka kërkuar që më parë. Më pas zonja Gjebrea, pastaj unë.

Arben Elezi – Unë jam për një dënim drastik, sepse këtu bëhet fjalë për jetën e njerëzve, jetën e fëmijëve tanë. Në qoftë se ne nuk e parandalojmë këtë person, si do ta verifikojmë? Sepse ne e dimë se sa i fuqishëm është kontrolli për sigurinë ushqimore, duhet të jemi realistë për këtë.

Ermonela Felaj – Ju jeni për një dëmtim më të rëndë në këtë paragraf?

Arben Elezi – Dënim shumë më të rëndë, sepse faktikisht, shteti duhet të jetë parandalues, jo të mbushë burgjet kot. E parandalojmë, e vëmë para përgjegjësie. Në qoftë se ai dënohet me dhjetë apo pesëmbëdhjetë vjet burg, duhet ta mendojë këtë, sepse importimi është shumë i rëndësishëm, edhe prodhimi, edhe ruajtja.

Ermonela Felaj – Të gjitha.

Arben Elezi – Të gjitha janë shumë të rëndësishme te paragrafi i parë.

Kaq kisha!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Sigurisht, bie dakord se ka shumë nevojë për rregullime. Të gjitha situatat e fundit, qoftë edhe ato të prodhuara mediatikisht, kanë treguar se ne çalojmë për sa i përket sigurisë ushqimore. Nga ana tjetër, duhet të jemi të qartë, që t'i dallojmë të gjitha hallkat. Mendoj se këtu nuk ka një dallim të qartë ndërmjet hallkave të prodhuesit, të importuesit, të tregtarit, dhe nuk mund t'i dënojmë të gjithë njëloj. Nga ana tjetër, këtë duhet ta rregullojmë.

Po ashtu, nuk e kuptoj këtë pjesën e barnave të rrezikshme. Çfarë nënkuptojmë? Diku thuhet “barna të rrezikshme”, diku thuhet vetëm barna. Unë mendoj se të gjitha këto nene kanë nevojë të shikohen edhe një herë, që të jenë të qarta, të dallueshme. Ndoshta Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese do të ketë fuqinë e nevojshme, që me ekspertizën t'i përcaktojë këto.

Sipas këndvështrimit tim, përveç asaj me të cilën bie dakord se është e nevojshme, shoh një konfuzion në lidhje me mënyrën si janë paraqitur dhe si janë futur të gjitha bashkë.

Me dëshirën për të rregulluar diçka, prishim diçka tjetër.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zoti Sterkaj!

Paulin Sterkaj – Unë kisha diçka tjetër: duhet edhe klasifikimi i këtyre produkteve. Sepse diçka vjen me dashje, diçka vjen pa dashje. Importuesi dëshiron të bëjë biznes. Nga X prodhues, atij mund t'i ofrohet një material. Ky e sjell materialin, por ai rezulton me probleme. Në këtë rast, quhet sikur personi e ka bërë me dije apo pa vetëdije, e ka bërë me dashje apo pa dashje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë kushtet e ruajtjes, kushtet e përpunimit. Pra, janë disa gjëra, kështu që kjo nuk duhet të jetë kaq brutale. Kjo punë duhet parë në mënyrë të hollësishme. Ma merr mendja se duhet një ndërhyrje e drejtpërdrejt te siguria ushqimore: të shikohet nen për nen, me specialistë, jo me deputetë. Deputetët mund të rregullojnë teknikën legislative, mund të rregullojnë masat e dënimit, por kjo çështje duhet parë nga specialistë të mirëfilltë.

Sepse, ne e kalojmë një nen, por nuk e dimë se cili është ai që bën dëm. Ai importon. Një fabrikë në Irlandë, po e çoj larg, ngaqë s'kemi mundësi të importojmë prej atje, i ofron një X prodhim në ato kushte siç e përdorin ata, në forma e mënyra të tjera. Ka shumë rëndësi mënyra e përdorimit, mënyra e ruajtjes dhe mënyra e trajtimit të produkteve. Sepse, nëse një produkt e bashkojmë me një tjetër, mund të krijohet diçka, që ne si deputetë nuk jemi në gjendje ta dikë. Janë specialistët ata që duhet ta përcaktojnë dhe duhet të futen thellë në këtë problem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Ju lutem, flisni vetëm me mikrofon dhe nëse keni një propozim konkret!

Paulin Sterkaj – Duhet të krijohet një grup specialistësh për të përcaktuar elementet e rrezikshme ushqimore.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Sterkaj!

Urdhëroni, zoti Shameti!

Adnor Shameti – Duke mirëkuptuar shqetësimet e drejta dhe të ligjshme të të gjithë kolegëve, ndaj të njëjtin shqetësim me ju. Unë ju ftoj ta kalojmë këtë se është një çështje të cilën nuk mund ta zgjidhim në Komisionin e Sigurisë. Në Komisionin e Ligjeve, duke qenë në procesin e miratimit nën për nën të këtyre ndryshimeve, jemi duke pritur opinionin përfundimtar nga Komisioni i Veprimtarive Prodhuese për dhënien e vendimit përfundimtar në bashkëpunim edhe me zyrën e EURALIS-it, Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Bujqësisë. Kështu që ju ftoj ta kalojmë këtë variant dhe në gjuhën përfundimtare, qoftë për ndërhyrjet për teknikën, për llojet, masat e gjithçka tjetër ju siguroj se do të gjejnë vend të gjitha sugjerimet e anëtarëve të nderuar të këtij komisioni.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Shameti!

Urdhëroni, zoti Duzha!

Luan Duzha – Unë bashkohem me dy kolegët e mi deputetë. Për mua paragrafi i parë është shumë i rëndësishëm, importimi dhe prodhimi, ruajtja e ushqimeve apo edhe barnave (brana të rrezikshme janë barnat e skaduar dhe u ndërrohet afati i përdorimit) dhe kjo bëhet me qëllim, nuk bëhet pa qëllim. Edhe kur merret jashtë një mall, që është i skaduar, merret me qëllim, nuk merret pa qëllim. Çdo mall që hynë,, çdo tregtar që e merr dhe e fut në Shqipëri e di se çfarë po bën. Çdo tregtar e merr me dashje, e fut me dashje në Shqipëri, ia heq datën e skadencës me dashje.

Pra, për mua ky paragraf është më rëndësishëm se të tjerët, prandaj ta kapim qysh në fillim.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Duzha!

Jeni i të njëjtit mendim, si edhe kolegu Elezi. Në fakt, edhe kolegë të tjerë patën një ndjeshmëri direkt ndaj masës së dënimit të propozuar për një nën, i cili ndonëse nuk e kërkon pasojën si shkak, gjithsesi ngelet e rrezikshme.

Të gjithë këto nuk janë veprime të kryera nga pakujdesia. Veprimet që përshkruhen te kjo dispozitë, të importosh, të prodhosh, të shesësh secilin nga ushqimet që citohen në dispozitë janë veprime që kryhen me dashje. Pra, ky është rasti që dënon dispozita, jo raste të tjera.

Kuptimi i dispozitës për zbatuesit është se veprimet janë me dashje në këtë rast, jo nga pakujdesia.

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Kam një pyetje për zotin Shameti. A ka ndonjë rast të ngjashëm në vendet e BE-së apo vendet e tjera afër nesh? Si është rregulluar në vendet e tjera importimi, prodhimi, tregtimi i ushqimeve, pijeve apo barnave?

Adnor Shameti - Faleminderit, zonja Gjebrea!

Këto gjejnë rregullim si me ndërhyrjen në ligjin penal përkatës, ashtu edhe në direktiva që ndryshojnë nga vendi në vend. Gjithsesi, në variantin përfundimtar që ne do të kalojmë do të kemi edhe propozimin konkret nga zyra e EURALIUS-it për të pasur përvojën më të mirë nga të gjithë vendet e BE-së në gjuhën përfundimtare që ky ligj do të ketë.

Faleminderit!

Elona Gjebrea – Kam vetëm një koment. Kur vjen relacioni për një projektligj shpjegohet edhe ku bazohet ky ligj dhe analogjinë që ka me vendet e tjera. Mirë do të ishte të jetë e shkruar, por meqë ju thoni se EURALIUS-i është në gjendje ta provojë këtë, po e presim.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Hedhim në votim propozimin më të largët. Propozimi është që të ndryshohet masa e dënimit duke u rritur (nuk e di a kishte ndonjë masë konkrete që do të donin ta propozonin kolegët, por të mos jetë kjo masë dënimi) 5 ditë deri në 3 vjet.

A mund të kemi një propozim, një masë që mendoni ju?

Luan Harusha – Unë mendoj se këto persona që gjenden duke bërë këto veprime nuk kanë asnjë ndryshim nga një kriminel dhe se dënimi duhet të jetë njësoj si një kriminel.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Atëherë, nuk kemi një masë konkrete dënimi. Ua japim këtë kohë kolegëve të tjerë të ligjeve që ta krahasojnë, por propozimi është i qartë në këtë komision, që në

paragrafin e parë masa e dënimit duhet të ashpërsohet. Ajo masë dënimi nuk është e mjaftueshme dhe duhet të shkojë krah dy paragrafëve të tjerë, pra të jetë po aq e rëndë.

Kush është dakord me këtë propozim?

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin?

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ju lutem, stafi ta mbajë shënim! Ajo që sugjerohet nga Komisioni i Sigurisë është që dënimi në paragrafin e parë të ashpërsohet, duke u përafëruar me dënimet e parashikuara në dy paragrafët e tjerë.

Kalojmë te neni tjetër.

Unë për lehtësi komunikimi nuk do të citoj ndryshimin e numërimit të neneve, për shkak të ndryshimit që ne propozuam më parë, por do të doja që edhe në këtë rast të bëj të njëjtën ndërhyrje, siç bëra në rastin e nenit “Për armëmbajtje pa leje”. Me sa duket sërish nuk është konsultuar varianti i përditësuar i Kodit, sepse pas nenit 288, në vitin 2001 është shtuar neni 288/a dhe pas nenit 288/a duhen shtuar nenet e tjera me radhë. Unë nuk kam nen 288/b në variantin formal të Kodit.

Atëherë i shohim nenet vetëm si propozim, ndërkohë këtu ka vlerë e njëjta vërejtje për numërtimin, pra për çdo nen të propozuar të përdoret nen i veçantë në tekstin e projektligjit dhe jo një nen nga teksti i projektligjit për një grup nenesesh.

Neni tjetër që propozohet është ai që lidhet me importimin, prodhimin dhe tregtimin e ushqimeve, pijeve, barnave dhe artikujve të tjerë ushqimor jashtë afatit të përdorimit.

Në rastin e parë është parashikuar që kjo të jetë kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim deri në dy vjet, ndërsa në rastin e dytë, kur kjo vepër mendohet se kryhet në bashkëpunim më shumë se një herë ose ka pasoja të rënda për shëndetin dënohet me burgim 3-10 vjet.

Urdhëroni!

Paulin Sterkaj – Unë do të kisha propozuar diçka më ndryshe. Çdo produkt ushqimor ka një afat të limituar të përdorimit dhe ka datën e skadimit. Unë mendoj që të mos lejohet asnjë produkt ushqimor në 30% e fundit të skadencës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Thashë të mos importohet 30%-shi. Në Europë nuk mund ta falsifikojnë, por e sjellin materialin këtu dhe thonë se është brenda datës së skadencës. Po të shkoni në supermarketet e Tiranës dhe të kërkonit për lider vaj ulliri, përveç vajit të ullirit të vendit, nuk gjeni dot një të vitit të fundit, por janë të gjithë 2, 3 ose 4-vjeçar. Vaji i ullirit ka një specifikë të veçantë, që sa më i ri të jetë, aq më vlera ushqimore ka. Prandaj, unë propozoj që të vihet një limit që të mos importohen prodhime të fazës së 30%-it të fundit të skadimit.

Ermonela Felaj – Të jem konstruktive me zotin Sterkaj, sepse propozimi i tij ka sens, ai propozon që të vihet një paragraf i veçantë, i cili penalizon lejimin e importimit para se një mall të skadojë dhe është afër afatit të skadencës. Mendoj se ne bashkë me komisionet e tjera mund të ndërtojmë një dispozitë të tillë veçmas për importimin. A ka sens shprehja: “Prodhimi i artikujve ushqimorë pas afatit të përdorimit”? Mua më duket pa sens si veprim. Ndërkohë, “vendosja në qarkullim”, e cila i nënkupton të gjitha veprimet, si: shitja, shpërndarja, transporti e të tjera me radhë, është një veprim që e ka brenda shitjen. Kështu që, zoti Shametaj, që të jemi më të qartë në këtë pikë, unë sugjeroj propozimin e parë të zotit Sterkaj, që lejimi i importimit afër afatit të skadencës të dënohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po e themi si ide për të ndërtuar dispozitën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prodhimi të dënohet veçmas kur ndodh me materiale të skaduara dhe vendosja në qarkullim pas afatit të skadimit të dënohet, por secila nga këto të jetë e penalizuar veçmas dhe në këtë mënyrë ne ndërtojmë dispozitën.

Paragrafi i fundit është paragraf i përgjithshëm, sepse dënon përsëritjen e veprës ose rastin kur ajo ka sjellë një pasojë. Ekziston një opinion i përgjithshëm që nga gjërat e skaduara nuk të ndodhë gjë, por që, në fakt, nuk është ashtu. Duhet të dimë se kur vendoset një datë, ajo është data e skadimit dhe nuk është data e prodhimit, sepse ka një konfuzion te njerëzit, që kur shohin një datë e marrin sikur është data e prodhimit, por përdorimi i një date tregon vetëm datën e skadimit. Gjithmonë kur ka vetëm një datë, ajo është e skadimit dhe jo e prodhimit.

Paulin Sterkaj – Nga eksperiencia dhe nga sa kam informacion, materialet e supermarketeve ushqimore janë qarkulluese dhe në shtete të ndryshme ka rrjete supermarketesh, ku 30%-shin e fundit që i afrohet datës së skadencës e tërheqin mallin nga supermarketet dhe e eksportojnë. Atë material, i cili është drejt skadencës, por brenda afatit, e sjellin në Shqipëri. Atë

mall, i cili nuk mund të ndalohet, sepse deri sot është parashikuar në ligj, e merr, e përpunon, i rregullon letrat dhe e lë aty edhe për 3 vjet, që do të thotë se ke ngrënë një ushqim të skaduar, ku pasojat janë në spitalin onkologjik.

Elona Gjebrea – Jam shumë dakord me dënimin për të gjithë tregtarët që abuzojnë me sigurinë ushqimore, por nuk duhet të kalojmë në ekstrem, sepse po të shikosh jashtë shtetit ka opsione të mallrave që kanë një afat të gjerë skadence dhe ka edhe nga ato afër skadencës, që e shesin me një çmim më të lirë. Kjo u ofron mundësi blerjeje edhe konsumatorëve, të cilët nuk kanë mundësi. Ne nuk duhet të kalojmë në ekstrem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk duhet ta ngatërrojmë faktin që e ndryshojnë me qëllim datën e skadencës me atë që ka edhe mallra që janë afër kufirit të skadencës. Nuk duhet të kalojmë në ekstreme, sepse kështu e kanë rregulluar edhe vendet e tjera. Ne nuk do të bëhemi eksperiment për çdo gjë. Prandaj them se duhet të jemi të qartë për këtë dhe nuk kemi pse ta ashpësojmë për sa kohë është sjellë një draft dhe ne kemi komente me draftin e sjellë.

Ermonela Felaj- Në fakt, Elona, ne nuk shkuam deri tek ashpërsimi...

Paulin Sterkaj – Jam shumë dakord për prodhimet e vendit, por ato të importuara kanë problemet mbrapa. Prodhimet e vendit mund ta ulin çmimin afër skadencës. Nuk dua të bëj antireklamë, por në një supermarket, jo shumë larg nga këtu, nuk gjen një ushqim që ka kaluar 30%-in e skadencës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka ardhur i freskët dhe tregtarët shqiptarët e shesin më lirë se ai që prodhohet në fabrikë. Ne nuk kemi nevojë të hamë mbetjet e Europës. Më mirë hamë një herë në vit, sesa ato që kanë pasoja shumë më të mëdha për shëndetin.

Ne po dënojmë me 5-14 vjet për armëmbajtje pa leje, pa kryer asnjë lloj akti, ndërsa këto që hamë pa pasoja.

Ermonela Felaj- Ju lutem, kolegë, sepse nuk po diskutojmë mënyrat tregtare sesi e bëjmë të mundur shitjen e mallit para se ai të skadojë, ne po flasim për rastin kur ka skaduar dhe e vë në qarkullim. Këtë po kërkojmë të dënojmë. Propozimet që u bënë në këtë komision janë që kjo dispozitë të riformulohet duke penalizuar veçmas importimin e mallrave të skaduar, duke penalizuar veçmas prodhimin e mallrave ushqimorë në ndërtimin e së cilës përdoren substanca të

skaduar dhe njëkohësisht në rastin kur kjo ka sjellë pasoja të dënohet. Këto janë propozimet që u bënë dhe më duken më se logjike dhe të duhura.

Ju falënderoj të gjithëve!

Kush është dakord me këto propozime për këtë nen?

Miratohet.

Kalojmë te neni “Mashtime me produktet ushqimore”, i cili është një nen i propozuar rishtaz dhe ka të bëjë me rastin kur në produktin ushqimor shënohen të dhëna që nuk i korrespondojnë përmbajtjes së vërtetë të produktit. Në këtë mënyrë, duke u shitur mallra që nuk kanë përbërësit e vërtetë dhe të duhur në përmbajtje përbën një sjellje që duhet të penalizohet, sepse mund të sjellë edhe pasoja të rënda. Prandaj propozohet që ajo të dënohet rëndë me një burgim që shkon nga 3-10 vjet. Propozuesit kanë kapur një rast të shfaqjes në praktikë të kësaj veprë, që është rasti kur ndërhyrja bëhet tek etiketa, te përbërja dhe tek ato që i shet konsumatorit sikur janë përbërja e vërtetë e mallit, origjina e tij e të tjera me radhë.

Paulin Sterkaj – Kush duhet të dënohet, ai që e tregton apo ai që e prodhon?!

Ermonela Felaj – Të gjithë. Ata që e importojnë, ata që e prodhojnë, ata që e ofrojnë..

Paulin Sterkaj – Çfarë faji ka ai?! Ai nuk ka laborator nuk e detyron ti një subjekt tregtar që të ketë një laborator për bazën ushqimore, por e detyron fabrikën që e prodhon, e cila ka vënë përshtkrimin e përmbajtjes së produktit.

Ermonela Felaj – Po ju jap shembullin, rasti i atyre që prodhojnë pije alkoolike. Ai nuk është i licencuar që të prodhojë pije alkoolike në shishe me etikë. Ai i vendos edhe një etiketë dhe ti e blen, sepse mendon se është prodhuar në një kantinë të vërtetë vere e të tjera me radhë. Ky është një rast që duhet dënuar. Ti i ke në masë pijet alkoolike...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti po hyn në çështjen të provuarit. Ne po themi se ti dënohesh kur e di këtë gjë, jo kur nuk e di. Mos hyni në çështjen e të provuarit, sepse këtu ngatërrohemi.

Rasti që sjell dispozita është: nëse ti je tregtar dhe më shet një pije në shishe me etiketë dhe thua verë e kantinës X, që është e njohur, ndërkohë ti që po ma shet mua e di këtë gjë, patjetër që duhet të dënohesh bashkë me atë që e ka bërë këtë gjë që në fillim. Pra, të gjithë i dënojmë njësoj.

Vijmë te ajo ndjeshmëria juaj, që e thatë shumë mirë: pse të presim sa të vijnë pasojat? Unë dua të luftoj me parandalim, që, kur hedh në treg mallin e skaduar, dua të dënojë rëndë. A

thamë këtu në komisioni?! E njëjta gjë është në rastin kur ti prodhon në formatin që nuk të është lejuar, sepse nuk i plotëson standardet. Fjala vjen të prodhosh qumësht në kuti kartoni, duhet të plotësosh ca kushte. Nuk mund të kalosh atje, në qoftë se ti që ma sjell qumështin, je një subjekt i panjohur në Tetra Pak. Duke mos qenë i licencuar, për ta bërë një gjë të tillë, natyrisht që duhet të dënohesh për këtë gjë. Këto janë raste që ne i kemi ndeshur pa fund, janë bërë mediatike, sigurisht kanë sjellë pasoja. Në momentin e parë mund të kenë qenë të padukshme dhe të panjohura, por me kalimin e kohës konsumatorët i kanë ndjerë. Nuk mund të mos themi që nuk i kanë ndierë. Kështu që ky është një propozim që vlen. Masat e dënimit që propozohen këtu janë burgim deri në 3 vjet dhe 3-10 vjet për rastin e përsëritjes dhe pasojës më të rëndë. A jeni dakord? Në qoftë se duan të shtojnë edhe ndonjë rast tjetër që nuk është këtu, e propozojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, është 5 ditë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Paulin Sterkaj – Ne të gjithë që bëjmë pazar. Zotëri, unë nuk e kam gojën laborator i them dua djathë, më thotë 10 mijë lekë kilja. E fus në gojë dhe gjysma është niseshte dhe gjysma është djathë. Atëherë, merret origjina e produktit, sepse edhe shitësi nuk është laborator. Pra, merret origjina dhe vihet para përgjegjësisë penale.

Ermonela Felaj - Në rregull, por unë shitësin e dënoj, në rast se e di, Paulin, dhe unë këtë do ta provoj. Në qoftë se nuk arrij ta provoj, nuk kam si ta dënoj shitësin.

Zoti Shameti, një opinion nga ju.

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Duke i mirëkuptuar të gjitha ndërhyrjet e kolegëve, dua t'ju sugjeroj që po merrni rolin e përfaqësuesit të prokurorisë në komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Absolutisht, ndaj të njëjtin shqetësim me ju dhe prandaj jam edhe një nga propozuesit e ndryshimeve. Çdo vepër penale, çdo akt, çdo kundërvajtje e secilit prej këtyre subjekteve, që janë përfshirë në dispozitat që keni përpara, të gjitha elementet e të provuarit i takojnë prokurorisë, që do ta shqyrtojë, rast pas rasti, secilën shkelje që do të bëjnë shkelësit e ligjit dhe do të identifikojnë edhe natyrën e veprës dhe të shikojnë se cila dispozitë është shkelur.

Kështu që ju ftoj, bashkë me sugjerimet që bëri zonja kryetare, që përmbledhin të gjitha ndërhyrjet e gjithsecilit në komision, ta miratojmë këtë dispozitë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – I vetmi propozim, në të cilin besoj se ishim të gjithë në një linjë, ishte ndryshimi i masës së dënimit, duke u ashpërsuar në paragrafin e parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë me të gjitha diskutimet që patëm...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe gjykata dhe të gjithë përdorin një logjikë, kështu që le t'ia lëmë Komisionit të Ligjeve që ta krahasojë me nene të tjerë të ngjashme, sepse Kodi nuk mund të parashikojë për këtë një dënim më të madh. Për shembull veprat penale, që drejtohen direkt kundër jetës, janë me dashje direkte.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, propozimi juaj është që të ashpërsohet, neni 288/d “Mashtrimi i produkteve ushqimore”. Propozimi është që në paragrafin e parë të ndryshohet masa e dënimit, duke u ashpërsuar në minimumin dhe në maksimumin e saj.

A jeni dakord kështu siç është shprehur?

Në rregull.

Faleminderit!

Urdhëroni!

Elona Gjebrea – Nuk jam juriste, vetëm se ka një gjë është aq e lodhshme që ta lexosh këtë paragraf. Paragraf më të gjatë se ky nuk kam parë ndonjëherë. Nëse mund ta rishikoni, sepse ju jeni ekspertë, ju e dini.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E di që duhen, por mund të ndahet në dy.

Ermonela Felaj - Nenin e miratuam.

Çfarë ka pa kaluar te neni tjetër?

Urdhëroni, zoti Harusha!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atë e kaluam. Çfarë problemi ka? A i ngritët duart? A ishit dakord që të ashpërsohet dënimi? Masën e thamë.

Masa nuk mund të bëhet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Luan, marrin 140 variante, masën do ta përcaktojnë në proporcionalitet për vepra të tjera. Nuk është kjo vepra më e rëndë e Kodit Penal.

Luan Harusha – Ju thoni për shitësin 7-10 vjet, për prodhuesin 0-3 vjet.

Ermonela Felaj - Jo, janë njësoj të penalizuar.

Luan Harusha – Herën e parë rrezikoj, për t'u bërë i pasur sa të mundem.

Ermonela Felaj – Zoti Luan, edhe një herë, sepse ngatërresa jote qëndron se ti merr çështjen konkrete dhe pretendon që ta provosh këtu. Nuk është ashtu, nuk lëviz në atë mënyrë procesi të provuarit. Të kuptuarit dhe të provuarit janë dy gjëra të ndryshme, në mënyrën se si kuptohet kjo dispozitë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, më lejoni, edhe për shkak të eksperiencës, sepse këtu jemi disa juristë, ta shpjegoj. Veprimet e shitjes, të importimit, të ruajtjes penalizohen të gjitha njësoj. Të gjitha janë nga subjekte, që kanë dijeni dhe duan t'i kryejnë këto veprime, nuk bëhet fjalë për subjekte që mashtrohen.

Luan Harusha – Unë them për prodhuesin.

Ermonela Felaj – Prodhuesin e ke të dënuar.

Luan Harusha – Unë dhe Paulini vijmë nga Shkodra, ka 27 vjet që një person kapet, lëshohet, arrestohet dhe lirohet.

Ermonela Felaj – Kjo është tjetër gjë, nuk ka lidhje me ligjin. Kjo ka të bëjë me zbatimin e gabuar të ligjit.

Luan Harusha – Kushedi sa njerëz kanë vdekur dhe asnjë nuk e merr vesh. Ai del nga burgu...

Ermonela Felaj – Dakord.

Luan Harusha – Ai del nga burgu dhe vazhdon aktivitetin. E kapin, dënohet 6 muaj apo 1 vit gjobë.

Ermonela Felaj – Luan, kjo është çështje e zbatimit të gabuar të ligjit dhe duhet të mbajnë përgjegjësi ata persona, që e zbatojnë ligjin. Ne nuk mund të japim dënime me vdekje.

Luan Harusha – Jo me vdekje, por njësoj si me vdekje. Unë si një kriminel e shikoj.

Ermonela Felaj – Nuk mund t'i japim këto lloj dënimesh

Luan Harusha – Unë e propozoj dënimin e këtij personi si një kriminel.

Ermonela Felaj – Kodi ka një logjikë dhe ruan një proporcionalitet masash, duke kuptuar se cila vepër është më rrezikshme dhe më e rëndë, ajo dënohet më shumë. A është kjo vepër, po aq e rëndë sa të themi si një vepër që kryen një organizatë kriminale, një bandë e armatosur, vrasje me paramendim e dikujt? Jo, nuk është aq e rëndë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është në atë masë, sepse vepra matet për rrezikshmërinë e saj, qoftë nga veprimet që ndërmerr autori, por qoftë dhe nga rrezikshmëria që paraqet vetë autori. Ne po flasim për persona, të cilët nuk kanë qëllim në vetvete që të vrasin njerëz, por kanë qëllim të fitojnë dhe këtë e bëjnë në një mënyrë të paskrupullt dhe për këtë po i dënojmë. Unë nuk po hyj në debat me ju se sa e doni personalisht masën e dënimit, por po them se ne këtu nuk do të binim dot dakord për një masë dënimi. Nuk jemi komision përgjegjës, nuk e vendosim ne këtë, sepse nuk e vendosim dot këtë, por ia lëmë një komisioni, që i ka në përbërje të gjithë juristë, që ta shikojë me dispozita të tjera të Kodit Penal dhe të gjejë një masë të duhur.

Ne po themi se si komision, do të donim që dënimi të mos ishte as 5 ditë, as 3 vjet burg. Luani do që ky të jetë dënim i përjetshëm. Dakord, këtë do ta diskutojë kështu edhe Komisioni i Ligjeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por në një grup dhe kudo funksionon parimi i shumicës. Nëse shumica është dakord me këtë mendim, do ta mbështesë. Nëse nuk është dakord, do të thotë që, gjithsesi e diskutoi variantin që ne patëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është e thënë që të mbetesh i vetëm me këtë mendim. Mund të ketë edhe të tjerë që mendojnë si ty.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, se sot kemi edhe një projektligj tjetër shumë të gjatë dhe nuk dua ta humbasim durimin për projektin tjetër!

Kalojmë te neni, që bën fjalë për thyerjen, heqjen, zëvendësimin e shenjave të sigurisë në fushën e sigurisë ushqimore.

Është rasti kur organet që kanë për detyrë të kontrollojnë subjektet që prodhojnë mallra ushqimore, konstatojnë që nuk ka ecuri të mirë të punës atje, ka shkelje në raport me ligjin. Për këtë arsye, ata ndërhyjnë duke vënë shenja që pezullojnë aktivitetin. Nëse këto shenja i prish, duke

dashur të japësh idenë te konsumatorët që je në rregull, apo që nuk ka ardhur asnjëherë te ty AKU-ja apo organet e tjera, edhe kjo sjellje propozohet të dënohet, madje është propozuar të konsiderohet si krim dhe jo si kundërvajtje. Besoj se ky është një rast i mirë, që është kapur nga praktika dhe është bërë figurë e veprës penale.

Ka ndonjë diskutim për këtë nen?

Paulin Sterkaj - Kjo më duket si fletë-rrufeja e shokut Enver. T'i vënë fletë-rrufenë në dyqan atij?! Le t'i vënë masën shtrënguese, atë penale apo atë administrative. Nuk ke pse t'i vësh vulë ti atij në dyqan. Do t'u japim prioritete disa dyqaneve kështu. Ky më duket ligj lobist. Në rast se ne vëmë vula në disa dyqane dhe nuk ka gjetur diçka, kur ti ke në dorë masën administrative dhe atë penale, pse duhet të jetë ky projektligj? Që t'i japë favore atij që nuk ka mundësi të hyjë AKU-ja brenda? Këtë duhet ta shohin kolegët e komisionit. Kjo nuk duhet të kalojë. Ky është ligj, që bëhet për interesa të caktuara, kryesisht për personat që kanë interesa të mëdha në këtë punë.

Nuk mund t'i vësh askujt fletë-rrufe apo vulë, por mund t'i vësh gjobë, masë administrative, apo penale e gjithçka, por në momentin që ai e ka kryer atë detyrim, ai mund të vazhdojë aktivitetin nga e para. Nuk ka pse t'i lësh fletë-rrufe apo vulë në dyqan.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Shameti!

Më pas e ka fjalën zonja Gjebrea!

Adnor Shameti - Faleminderit, zonja kryetare!

Ju sugjeroj që dispozita të miratohet në variantin e formuluar. Kini parasysh që është një dispozitë e re, që nuk ka qenë e parashikuar më parë në Kodin Penal, që rregullon në mënyrë të detajuar marrëdhënien shoqërore që ka të bëjë me këtë shkelje në këtë fushë. Kështu, ju ftoj ta kalojmë siç është. Është në të njëjtën linjë dhe në të njëjtën gjuhë me dispozitat paraardhëse në ruajtjen e sigurisë ushqimore për të gjithë konsumatorët.

Faleminderit!

Paulin Sterkaj - Unë propozoj që ky propozim të hidhet në votim.

Ermonela Felaj – Patjetër, çdo gjë do të hidhet në votim.

Paulin Sterkaj – Për shqetësimin, se ky është autor i projektligjit, një nga firmëtarët dhe po e mbron këtë nismë. Ne jemi deputetë të Komisionit të Sigurisë. Nuk jemi komision

përgjegjës, por për pjesën e sigurisë unë nuk e toleroj askënd, që thyen sigurinë, e kam bindje këtë. Aq më shumë kur cenohet edhe ligji për konkurrencën. Nuk e kuptoj se si mund të vihet një vulë apo një shenjë që ta shohë publiku që të mos blejë në atë dyqan. Ju po thoni të falimentojë ai.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai paguan gjobën, nëse e ka shkelur rregullin. Ai dhe kush e ka prodhuar atë produkt.

Ermonela Felaj – Paulin, nuk janë shpikur masat që merr. Këto masa i marrin organet e kontrollit të ushqimit.

Paulin Sterkaj - Kjo nuk duhet të parashikohet në Kodin Penal.

Ermonela Felaj – Të lutem!

Nuk po parashikojmë këtë në Kodin Penal, se i ka parashikuar një ligj tjetër për organet që kontrollojnë sigurinë ushqimore që në rast se konstaton shkelje, të marrë 1-2-3 masa.

Unë nuk e di se cili është rasti në praktikë, se nuk jam personi që vij nga kjo praktikë.

Ajo që thotë dispozita është ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, Paulin!

Ne po flasim për një marrëdhënie midis subjektit tregtar dhe subjektit kontrollues. Kur tregtari i zëvendëson rregullat, i falsifikon shenjat e ndryshme që unë i kam vënë për shkak të ligjit, si organ zbatues, këtë dua të dënoj. Konsumatori nuk ka punë në këtë mes, se ai është pësuesi i dëmit dhe për këtë shkak ne po dënojmë tregtarin, por marrëdhënia është e tillë, është mes tregtarit dhe organit të sigurisë që i ka shkuar për kontroll, që ka vënë disa shenja, ka lënë disa detyra dhe tregtari mund t'i zëvendësojë, t'i heqë apo i prishë, që ato të mos figurojnë. Ky është rasti për të cilin bëhet fjalë. Të mos keqkuptohemi! Ndoshta edhe unë e shpjegova sikur dyqanet do të rrethohen me shirita si vendi i krimit. Ato janë masa të parashikuara në një ligj tjetër dhe nuk janë objekt i diskutimit tonë.

Ne po themi që mbi ato masa që ka marrë organi, që i di më mirë Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, nuk i dimë ne, po i theve, po i falsifikove ato masa, do të dënohesh.

Paulin Sterkaj - Ku e keni marrë këtë praktikë?

Ermonela Felaj – Paulin, janë disa propozues, nuk është një propozues.

Paulin Sterkaj – Për çdo propozim që po bëni, thoni se do ta konsultoni mbrapa. A jeni konsultuar para se ta bënit këtë projektligj? Çfarë praktike europiane keni marrë si shembull për këtë nismë?

Ermonela Felaj – Fjalën e ka zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Jo, kam një pyetje çfarë ndryshimi ka zëvendësimi me ndërrimin këtu? Është përmendur: thyerja, heqja, ndërrimi, zëvendësimi ose falsifikimi.

Ermonela Felaj – Për mendimin tim, duhet të ketë vetëm kuptimin e thjeshtë gjuhësor. Zëvendësimi është ta ndërrosh me të njëjtën gjë, ndërsa në rastin e ndërrimit mund ta ndërrosh edhe me diçka tjetër. Po t'i referohemi fjalorit të gjuhës shqipe, duhet të ketë një dallim të qartë midis fjalës “zëvendësoj” me fjalën “ndërroj”.

Të dyja fjalët janë fjalë shqipe. Megjithatë, ndërhyrja e zonjës Gjebrea vlen që Komisioni i Ligjeve ta bëjë këtë verifikim nëse këto dy fjalë, sipas fjalorit të gjuhës shqipe nënkuptojnë të njëjtën gjë. Është detyrim për zbatuesit në praktikë që një ndër interpretimet që përdorin, është edhe interpretimi gjuhësor për të kuptuar dispozitën. E kanë të detyruar këtë.

Po, zoti Vorpsi!

Sadi Vorpsi - Faleminderit kryetare!

Unë besoj se problemet dolën këtu.

Meqë jemi në fund, unë jam plotësisht dakord me mendimin e Paulinit për sa i përket nenit 288. Të paktën nga praktika, por edhe eksperiencia ka treguar që është abuzuar shpesh konkurrenca e lirë me këtë historinë e shiritave. Për sa kohë kemi masa administrative, ne nuk mund ta çojmë dot këtë gjë përtej, duke e parashikuar, duke e shtuar në Kodin Penal.

Unë mendoj se nuk duhet të jetë fare, të paktën në eksperiencën time, aty ku kam shërbyer para 4 vjetësh është përdorur për të prishur konkurrencën e lirë. Shumë biznese edhe me masa administrative, siç tha edhe Paulini, me vënien e shiritit edhe kanë falimentuar. Kaq kisha.

Ermonela Felaj – Domethënë, ju propozoni që ky nen ose përmbajtje, pra këto veprime, të mbeten në kuadrin e veprimeve të dënueshme administrative dhe jo penale?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po në qoftë se propozojmë: “kur më parë është marrë masa administrative dhe ti vazhdon të bësh të njëjtën gjë”, do të kishte sens?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndërhyrja e zotit Vorpsi më duket me vend, sepse iu bashkua...

(Deputeti Sterkaj ndërhyn pa mikrofon.)

Paulin Sterkaj – Çfarë është vepër...

Ermonela Felaj – Një veprim do ta bëjnë ato.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk mund të nisemi nga paragjykimi, se ashtu i bie që çdo organ vepron gabim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Paulin Sterkaj – Lërjani gjobën.

Ermonela Felaj – Ka propozim tjetër?

(Diskutime në sallë)

Ju lutem, kolegë!

Fjalën e ka zoti Harusha dhe pastaj zonja Dhima.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Luan Harusha – Jo burgim të përjetshëm, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndoshta masa tjetër mund të jetë mbyllja e biznesit.

Ermonela Felaj – Ajo është masë administrative, që nuk e diskutojmë në Kodin

Penal.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Luan Harusha – Kur t'i mbyllësh biznesin, e ke kryer punën.

Burgu...

Ermonela Felaj – Dakord.

Luan Harusha – Ai mund të hyjë në burg, por mund të lërë pasardhësin e tij në

biznes.

Ermonela Felaj – Pra, ju jeni te masa administrative në këtë rast.

Luan Harusha – Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Bëtë kapërcim shumë të madh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e ka zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë mendoj që duhet ta hedhim në votim propozimin e dhënë nga grupi i deputetëve, pasi e gjej me vend si propozim, sepse, patjetër, institucionet do t'i marrin masat administrative, por ndodh që këto të fundit nuk zbatohen nga ana e subjekteve.

Kështu që një ndëshkim më i rreptë në bazë të ligjit dhe ndryshimeve që do të sjellë Kodi, patjetër që do t'i ndërgjegjësojë prodhuesit dhe importuesit që ta zbatojnë më mirë ligjin.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Dhima!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në përgjithësi, për këtë nen pati disa mendime. Njëri prej tyre është që të mos jetë pjesë e Kodit Penal ose, në qoftë se do të jetë, të jetë pasi është zbatuar më parë një masë administrative.

Në fakt, të gjitha vendosjet e shenjave janë në vetvete masa administrative, por më mirë të themi: “kur janë ezauruar të gjitha masat administrative, të vijmë te penalizimi me Kod Penal”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, është ezauruar edhe ajo pjesë dhe ti e heq edhe shenjën që të ka treguar mbylljen e biznesit, e gris procesverbalin dhe vazhdon ushtrimin e biznesit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë pra, por ky është kuptimi i dispozitës!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Shameti.

Adnor Shameti – Ndërhyrjen e kam për procedurë dhe për t'i përmbledhur të gjitha qëndrimet e kolegëve. Unë insistoј në atë që kjo duhet të kriminalizohet në variantin që e kemi paraqitur, ndaj sugjeroј që për veprimtarinë e Komisionit për Sigurinë Kombëtare të hidhet në votim propozimi i dy kolegëve të nderuar, Sterkaj dhe Vorpsi, pastaj të vazhdojmë me miratimin.

Ermonela Felaj – Kam përshtypjen që, të paktën, zoti Vorpsi është dakord që, pasi të jenë ezauruar të gjitha masat administrative, të vijmë te Kodi Penal.

Adnor Shameti – Atëherë, hedhim në votim propozimin e zotit Sterkaj dhe të zotit Harusha, që ishin për dekriminalizimin e gjësë.

(Deputeti Sterkaj flet pa mikrofon.)

Jo, jam shumë serioz!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta hedhim në votim.

Ermonela Felaj – T’i japim pak drejtim mbledhjes?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Paulin Sterkaj – Shenjat nuk duhet të jenë shenja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Zoti Sterkaj, kjo nuk është pjesë e këtij ligji!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këto aspekte nuk i parashikojmë në këtë ligj, por janë parashikuar tjetërkund. Nëse e keni merak, e marrim atë ligj dhe e shikojmë. Por nuk ka lidhje Kodi Penal me shenjat.

Paulin Sterkaj – Ç’ lidhje ka Kodi Penal, pra?! Pse, kur hiqen shenjat, do dënohet ai?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Ka lidhje, sepse ti heq një shenjë për ta hedhur mallin në qarkullim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj ta ka vendosur shenjën, që të mos e hedhësh...

Paulin Sterkaj – A ka mundësi të di, çfarë shenjash konvencionale ka? Të paktën, ta dimë çfarë quhet shenjë.

Ermonela Felaj – Për këtë përgjigje kaq të hollësishme do të duhej të ndiqnim mbledhjen e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo më kot e thashë, se ndoshta ndodh që propozimet e sjella për Kodin Penal të shikohen nga disa komisione, sepse, në mënyrë tradicionale, dy komisione i kanë parë: komisioni ynë dhe Komisioni i Ligjeve, ku ky i fundit ka qenë gjithmonë komision përgjegjës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, ne mund të kemi vështirësi në kuptimin e drejtë, që na mungojnë në mbledhje personat specialistë për këtë çështje.

Megjithatë, në fund të fundit, detyra jonë nuk është të përcaktojmë masat që duhet të marrin autoritetet e kontrollit të ushqimit, ato tatimore, ato doganore e të tjerë, por të sigurohemi që këto janë masat e duhura dhe, duke qenë të tilla, nuk cenojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve. Për këtë jemi ne dhe këtë pjesë duhet të konsiderojmë, pavarësisht dëshirës që kemi që të investohemi edhe më shumë se kaq.

Atëherë, besoj se propozimi më konstruktiv që bëhet në këtë komision është: pasi të jenë ezauruar të gjitha masat administrative, të mund të vijmë te ky nen. Kush është dakord me këtë vërejtje që u mbajt për këtë nen?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vijmë te neni i fundit i propozuar “Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit”, ku është bërë vetëm një ndryshim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, është një lidhëz bashkërenditëse, siç është lidhëza “dhe”, e cila është zëvendësuar me një lidhëz tjetër “ose”, që është lidhëz veçuese, thjesht për t’u kuptuar qartë në praktikë, se nuk kërkohet që edhe t’u vësh pengesa, edhe t’i ndalosh me çdo mënyrë mjetet që të qarkullojnë, në mënyrë që të dënohesh. Por mjafton secili nga veprimet: qoftë të vësh pengesa, qoftë të pengosh qarkullimin, që të dënohesh. Aktualisht, dënimi është ai që ka qenë prej shumë vitesh në Kodin Penal, që parashikohet në nenin... Pra, nuk është një nen i propozuar rishtazi, por që e kemi në Kodin Penal.

Ndryshimi i propozuar në nenin 293 “Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit”, që, sipas shënimeve që ka Kodi, është që prej vitit ’95, kur është propozuar Kodi, është thjesht të ndryshohet lidhëza, në mënyrë që dispozita të bëhet më e qartë. Kush është dakord?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe ky nen.

Te neni i fundit “Hyrja në fuqi” propozohet që të gjitha ndryshimet, që ne kemi diskutuar për Kodin Penal përgjatë këtyre tri javëve në komisionin tonë, të hyjnë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Kush është dakord me nenin e fundit të draftit?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

E hedhim projektligjin në votim në tërësi, gjithmonë sipas propozimit të bërë nga kolegu Shameti, si përfaqësues i firmëtarëve, që të gjitha propozimet tona të mund t'i sqarojë.

Ne do të përpiqemi t'i sqarojmë në raportin tonë, por, sigurisht, prezenca juaj në Komisionin e Ligjeve na ndihmon që ju të sqaroni konkretisht se cila ka qenë ideja e komisionit, kur i ka bërë ato sugjerime.

Kush është dakord me miratimin në tërësi të neneve të propozuara në Kodin Penal?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohen edhe në tërësi ndryshimet e propozuara në Kodin Penal.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të kemi një pushim prej pesë minutash, për të vijuar më vonë me shqyrtimin e një projektligji të ri.

Adnor Shameti – A ka mundësi të them diçka?

Ermonela Felaj – Po, zoti Shameti.

Adnor Shameti – Në emër të të gjithë propozuesve të projektligjit për ndryshimet në Kodin Penal, dua t'i falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit për Sigurinë Kombëtare për sugjerimet e vlefshme dhe për gjetjet individuale dhe në tërësi të komisionit. Ju siguroj që në Komisionin e Ligjeve do t'i përcjellim me detaje të gjitha këto gjetje, sugjerime dhe rekomandime, në mënyrë që në përfundim të kemi variantin më të mirë të mundshëm, bazuar edhe te vërejtjet tuaja.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Do të rifillojmë pas një pushimi pesëminutësh.

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.06.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.”

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Elena Xhina, Sadi Vorpsi, Luan Duzha, Luan Harusha, Antoneta Dhima, Elona Hoxha, Edmond Rrushi, Paulin Sterkaj, Lefter Maliqi dhe Arben Elezi

Mungojnë:

Xhemal Qefalia, Eljo Hysko, Anduel Xhindi, Ylli Shehu dhe Myslym Murrizi

Të ftuar:

Erjon Luci- Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Artur Kala - Administrator i AAPSK në Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Gloria Çarkaxhiu – Specialiste në Sektorin e Studimeve Juridike dhe Analizës

Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Siç e njoftuam edhe në hapje të mbledhjes, si pikë të fundit të rendit të ditës për këtë mbledhje të Komisionit të Sigurisë Kombëtare, kishim parashikuar edhe projektligjin “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, që është sjellë rishtas në Kuvendin e Shqipërisë, ligj për të cilin ne jemi komision për dhënie mendimi. Dua të sjell paraprakisht në vëmendje të kolegëve se nga Ministria e Financave është propozuar një paketë me disa ligje dhe një nga këto është ky ligj, kurse të tjerët do t’i kemi në kalendarin në vijim. Këto ligje vijnë si zbatim i rekomandimeve që Komiteti *Moneyval*-it i Këshillit të Europës për të ndërmarrë të gjitha masat për luftën kundër financimit të terrorizmit, që i ka orientuar shtetit shqiptar. Pak më herët në Shqipëri ka qenë edhe drejtuesi i *Moneyval*, i cili ka pasur takime me përfaqësuesit më të lartë të institucioneve shtetërore në Shqipëri, si me Kryeministrin dhe shumë të tjerë, ka zhvilluar po ashtu takime edhe në Kuvendin e Shqipërisë, kështu që, në njëfarë mënyre, ne si kryetarë komisionesh, e kam fjalën për mua, për kryetarin e Komisionit të Ligjeve dhe kryetarin e Komisionit të Ekonomisë, jemi në dijeni të kësaj pakete që po punohet nga qeveria, e cila është shumë e rëndësishme. Është shumë e rëndësishme që shteti shqiptar t’i plotësojë detyrimet e tij në raport me masat që rekomandon *Moneyval*-i, me qëllim që të mund të plotësojmë të gjithë korpusin e atyre detyrimeve që e bëjnë shtetin shqiptar të denjë për të kërkuar çeljen e negociatave.

Sot do të kemi vetëm diskutimin në parim, meqenëse projektligji është i gjatë, i ri dhe natyrisht meriton një kohë të arsyeshme për t’u njohur mirë nga kolegët dhe për të bërë të gjitha sugjerimet e mundshme.

Për të prezantuar projektligjin kemi të ftuar zëvendësministrin e Financave dhe Ekonomisë, zotin Erjon Luçi.

Zoti Luçi, mirë se keni ardhur në Komisionin e Sigurisë!

Zoti zëvendësministër shoqërohet nga administratori i Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, zoti Artur Kala.

Faleminderit, zoti Kala!

Mirë se erdhët!

Në mos gaboj, agjencia është krijuar në vitin 2005 mbi bazën e një vendimi të Këshillit të Ministrave, ndërkohë që tani, me ligjin që propozohet, agjencia do të funksionojë me një ligj organik të vetën.

Nga Ministria e Drejtësisë kemi ftuar zonjën Gloria Çarkaxhiu, specialiste në sektorin e studimeve juridike dhe analizës ligjore.

Relatore nga Komisioni për Sigurinë Kombëtare është caktuar zonja Antoneta Dhima.

Fjalën po ia kaloj zotit Luçi për të na bërë një prezantim të përmbajtjes së projektligjit të propozuar dhe të qëllimit të tij, megjithëse në të gjithë dokumentin bashkëngjitur projektligjit ka një informacion të detajuar për arsyet që kanë çuar në nevojën për një ligj të tillë.

Më pas do t'ia jap fjalën zotit Kala, nëse do të ketë diçka për të shtuar.

Fjala për ju, zoti Luçi.

Erjon Luçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Pak a shumë ju e sqaruar pjesën e paketës që ka ardhur te komisioni juaj si nismë për të përmbushur të gjitha kërkesat e *Moenyval*-it, ku, një ndër to është pikërisht nisma për forcimin e Agjencisë për Administrimin e Aseteve të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Mirë do të ishte që ne të arrinim ta miratonim këtë paketë përpara fundit të vitit, nga vjeshta, kështu që jemi në kohë edhe për ta arritur si objektiv.

Kjo paketë është pak më e veçantë se pjesa tjetër, që është e lidhur direkt me pjesën e pastrimit të parave. Njëkohësisht është shumë e rëndësishme brenda asaj pakete, por edhe për vetë agjencinë, pasi ajo vepron me një VKM. Tashmë agjencia është rritur dhe forcuar në atë pikë që mund të përballojë një punë edhe pak më të gjerë, siç synon ligji, dhe jo thjesht përfshirjen e asetëve që vijnë si rrjedhojë e ligjit antimafia apo edhe të pjesës tjetër ilegale, si dhe të fusë elemente të tjera të ligjit penal, me qëllim shmangien e një diskriminimi mes mënyrës se si trajtohen asetet, si dhe duke pasur parasysh kapacitetet dhe harmonizimin që ka arritur agjencia në menaxhimin e këtyre asetëve për të mos humbur vlerën në kohë, si në aspektin e përdorimit të mjeteve të tyre në rast se vendimi është në favor të shtetit, ashtu dhe në rastin kur ato duhet të kthehen. Gjithmonë shteti duhet të minimizojë koston e një kompensimi të mundshëm që vjen nga amortizimi i këtyre asetëve. Ndaj dhe kjo është një paketë shumë e rëndësishme për t'i dhënë një shtysë tjetër agjencisë, që të kalojë në një standard të konsoliduar të mënyrës si ne menaxhojmë këto lloj asetesh.

Përtej këtij komisioni dhe *Moneyval*-it ne kemi nisma të ngjashme edhe me bankat, siç është ligj “Për administrimin e bankave” që ka kaluar nëpër komisione, si “*Banking Resolution Law*”. Të njëjtën gjë po bëjmë edhe për qeverinë vendore, që është në nivel nënligji, ose instruksionesh, dhe që ka si synim çfarë ndodh nëse gjendemi përpara këtyre rasteve. Kështu që janë praktika relativisht të mira dhe agjencitë përkatëse, që zbatojnë këto lloj praktikash, janë kritike për të mos lejuar gërryerjen e vlerave të aseteve të ndryshme, që, për momentin qarkullojnë jashtë agjencisë, pavarësisht se mund të kishin ardhur në agjenci me një koordinim më të mirë, por ky ligj e bën më detyruese trajtimin e këtyre aseteve nga agjencia.

Duke qenë se drejtori është edhe udhëheqës, edhe marrës i asistencës së është dhënë për këtë ligj, i cili është bërë bashkë me një grup italian, do t’ia kaloja fjalën për ndonjë shtesë të mundshme, megjithëse ai ka pjesën e neneve, të cilat do t’i kalojmë një e nga një dhe do të keni rast për të diskutuar elemente të ndryshme të këtij ligji.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Fjala është për ju, zoti Kala.

Artur Kala – E nderuar kryetare e Komisionit të Sigurisë,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Kam kënaqësinë që jam përpara këtij komisioni të nderuar për të prezantuar ligjin “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”!

Fillimisht e nisëm si ligj për agjencinë, por pastaj menduam që Shqipëria nuk ka një ligj për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Deri më sot agjencia ka funksionuar në zbatim të ligjit nr. 10192 dhe kemi administruar pasuri që rrjedhin nga ky ligj, si dhe të ligjit “Për masat kundër financimit të terrorizmit. Nevoja solli që të vendoset një regjim administrim për të gjitha pasuritë, që të mos kemi dy standarde.

Ndërkohë, me këtë ligj, ne arrijmë në një nivel më të lartë të të gjithë procesit aktual të administrimit të pasurive, duke vendosur në themel ligjor procedurën që agjencia ndjek sot, përfshirë të gjitha pasuritë që sekuestrohen dhe konfiskohen në fushën e veprimit të agjencisë, siç janë pasuritë që rrjedhin nga Kodi Penal, shitjen e pasurive të luajtshme në sekuestro, pasuri që u bie vlera. Ky është një rekomandim i vazhdueshëm i ekspertëve dhe i ndërkombëtarëve, pra që shitja e pasurive të luajtshme në fazën e sekuestros është shumë e rëndësishme për të eliminuar humbjet dhe për të mbajtur vlerën reale, pastaj vendoset ngrirja dhe kthimi ose kalimi në buxhet të shtetit sipas vendimeve të gjykatës. Synohet të shërbejë edhe si ligj, siç e cilëson edhe më lart

“organikë për agjencinë”, sepse agjencia funksionon mbi bazën e VKM-së nr. 687. Gjithashtu, vendosja në një regjim administrimi për të gjitha pasuritë do të bënte që të kishim një statistikë kombëtare, pasi Shqipëria sot nuk ka një statistikë kombëtare të unifikuar për të gjitha pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara. Ne kemi vetëm financim të terrorizmit dhe antimafigen, të cilat i raportojmë vazhdimisht, kurse për të tjerat, ngaqë nuk ka një shtrat menaxhimi, nuk ka një statistikë të tillë. Me bazën e të dhënave që kemi realizuar këto ditë, arrijmë të kemi një statistikë kombëtare.

Ne jemi munduar që në relacion të japim një shpjegim sa më të qartë të këtij projektligji dhe nevojën e tij, gjithsesi jemi të hapur për çdo pyetje apo koment. Edhe ju ishit shumë të qartë për pjesën e nevojës.

Ju faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Kala!

Tani do t’ia kaloj fjalën relatores për të na bërë një përmbledhje. Do t’ju lutesha të mos bini në përsëritje, por të evidentoni gjërat e reja që sjell ky projekt.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, zoti Luçi!

Faleminderit zoti Kala, administrator i Axfhencisë së administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Projektligji që po diskutojmë sot ka për qëllim përmirësimin e procesit të administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Çështja e administrimit të pasurive është diskutuar shumë në forumet ndërkombëtare dhe rajonale. Standardet përkatëse ndërkombëtare theksojnë se juridiksionet duhet të kenë mekanizma ligjorë për të menaxhuar në mënyrë efektive pasuritë e ngrira dhe ato të konfiskuara, të cilat janë në pritje të një vendimi, që do të merret në vazhdimësi.

Në radhë të parë, projektligji synon ngritjen e një niveli më të lartë të të gjithë procesit aktual të administrimit të pasurive, duke vendosur në themele ligjore procedurën që ndjek kjo agjenci që nga momenti i parë i ekzekutimit të vendimit të sekuestros, deri në marrjen në dorëzim të pasurive që do të administrohen, duke vijuar më pas me menaxhimin e tyre sipas mënyrave dhe formave specifike, në varësi të llojit të pasurisë, duke mbyllur qarkun e administrimit me anë të procesit të definimit përfundimtar të pasurive që konfiskohen.

Një objektiv tjetër është edhe ai përfshirjes së të gjitha pasurive që sekuestrohen dhe konfiskohen, si në procesin penal, ashtu edhe në atë parandalues, në fushën e veprimt të Agjencisë

së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, duke e përqendruar administrimin e të gjitha pasurive me prejardhje të paligjshme në një institucion të vetëm, që është kjo agjenci.

Një synim tjetër madhor, që përmbush një rekomandim të rëndësishëm të disa ekspertëve ndërkombëtarë, është edhe shtimi i kompetencës së shitjes së pasurive të luajtshme, të cilat prishen, amortizohen apo u bie vlera shpejt, që në fazën e sekuestrimit, duke mos pritur vendimin përfundimtar të konfiskimit.

Përdorimi i kësaj procedure do të bënte që vlera e realizuar nga shitja e pasurive të ruhej në një llogari bankare të veçantë dhe, në rast revokimi të sekuestrimit, t'i kthehet pronarit të ligjshëm, ndërsa në rastin e konfiskimit, të kalonte në buxhetin e shtetit.

Shitja e parakohshme e këtyre pasurive të sekuestruara, normalisht, do të sillte një përfitim për të gjithë, pasi jo vetëm ruhet vlera momentale e pasurisë së luajtshme (në rastin konkret, autoveturë, pajisje teknologjike, të IT-së, gjësë së gjallë e të tjerë), e cila do të humbte fare nëse këto pasuri do të mbaheshin deri në përfundim të afatit të procedurave gjyqësore, por edhe shkurtohen ndjeshëm shpenzimet e agjencisë për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre.

Së fundi, synohet që ky projektligj të shërbejë edhe si ligj organik për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, duke përcaktuar me norma ligjore organizimin, funksionet dhe kompetencat e kësaj agjencie.

Nisur nga rëndësia që ka ky projektligj, ftoj të gjithë kolegët dhe koleget deputete ta miratojnë atë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Dhima!

Për ta bërë të qartë edhe për kolegët, propozohet të ketë një administrim të përqendruar të të gjitha sendeve të sekuestruara dhe të konfiskuara, jo se nuk e njohim deri më sot këtë formë, sepse e thashë, që nga viti 2005 (të paktën, me sa u informova) agjencia e administrimit të sendeve, mallrave të luajtshme apo të paluajtshme, të sekuestruara dhe të konfiskuara, me vendim gjykate ekziston. Pra, ne e njohim këtë formë, por synohet të rregullohet me ligj, jo të marrë detyrime nga ligje të ndryshme.

Së dyti, synon të zgjerohet rrethi që menaxhon agjencia në fjalë. Pra, jo vetëm asete të sekuestruara si pasojë e ligjit të njohur si ligji antimafia, që, aktualisht, e zbaton Prokuroria për Krimet e Rënda dhe Gjykata për Krimet e Rënda, por të futen këtu të gjitha asetet që sekuestrohen

dhe konfiskohen për rrjedhojë të ligjit për masat kundër financimit të terrorizimit, si dhe një pjesë e sekuestrimeve, të cilat bëhen nga prokuroria për shkak të detyrimeve që ia ngarkon ligji.

Meqenëse jemi në Komisionin e Sigurisë, duhet të bëjmë një dallim të vogël. Sekuestrimi është një masë, që e përdor prokuroria për të gjetur prova, ndërsa konfiskimi, në vetvete, është një mënyrë fitimi pronësie, sepse me vendim të gjykatës përcaktohet se kujt do t'i kalojë pronësia mbi sendin ose asetin e sekuestruar. Kjo është ideja.

Ligji parashikon që edhe agjencia, në vetvete, të ketë një rritje të numrit të punonjësve.

Për pjesën e diskutimit, që lidhet me ndikimin buxhetor, ky është një ligj që ka efekte në buxhet. Efektet janë të natyrës rritëse. Kërkohej të shtohet personeli në këtë agjenci, sepse volumi i punës që ata duhet të kryejnë është shumë i madh. Pra, nga 8 punonjës, aktualisht, numri të shkojë në 19. Njëkohësisht, të fillojë të hyjë në përdorim teknologjia, digjitalizimi (drejtori, me të drejtë, tha se nuk i kemi të evidentuara), si dhe detyrime të tjera, që ne do t'i shohim rast pas rasti në diskutimin nën për nën. Në parim, këtë na propozon ky projekt.

Gjithsesi, për të sqaruar më gjatë, sipas Rregullores, do t'ua kaloj fjalën kolegëve, nëse kanë pyetje, për detyra të mëtejshme ose për veprimin në praktikë, që supozohet të mbajë kjo agjenci, për varësinë e saj e të tjerë.

Zonja Gjebrea, fjala për ju.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Dëshiroj të falënderoj paraprakisht zëvendësministrin dhe drejtorin e institucionit, që merret me konfiskimin dhe sekuestrimin e aseteve, të pasurive. Në fakt, titullin e keni administrator, në mos gaboju...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kryeadministrator, se po shikoj këtë...

Nga eksperiencia që kam pasur në punët e mëparshme, dua të them se është vërtet një agjenci funksionale. Më vjen mirë që të gjitha hapësirat, të cilat duhet të bëheshin, për më tepër, edhe si përgjigje e raportit të vazhdueshëm të Moneyval-it, gjejnë pasqyrim në këtë projektligj, që, për hir të së vërtetës, ia vlen të përshëndetet për faktin që ka pasqyruar edhe një raport të vlerësimit të ndikimit. Nuk na ndodh shpesh të vijnë projektligje të pasqyruara, të detajuara më vlerën buxhetore përkatëse dhe, në këtë mënyrë, më të kuptueshme edhe për ne, si deputetë.

Ju përmendni këtu (kisha edhe disa fjalë për ju, zoti Artur) disa elemente, që kanë të bëjnë me fuqizimin e strukturës suaj.

Si e keni menduar ju këtë strukturë? Sa punonjës shtesë do të ketë kjo strukturë në këtë institucion?

Së dyti, më bëri përshtypje fakti që ju thatë se nuk ka statistika. Besoj se ju keni një *database*, sepse, me aq sa di, është bërë puna nga ju. Ndërkohë, nëpërmjet projekteve, ju jepni mbështetje për shumë organizata të shoqërisë civile, të cilat, me anë të këtyre aseteve, u vijnë në ndihmë projekteve të ndryshme që do të implementojnë, që merren nga institucioni juaj.

Si e shikoni këtë gjë?

Sa kohë duhet të bëhet funksionale kjo strukturë që propozoni?

Çfarë shikoni si pengesë?

Në fakt, kjo është një iniciativë që, në njëfarë mënyre, ju jep shumë përgjegjësi, por, nga ana tjetër, këto janë përgjegjësi të nevojshme, për sa kohë janë reflektuar nga boshllëqet dhe pengesat që keni hasur në punën tuaj.

Sigurisht (ky është një sugjerim), do të doja të kishte sa më shumë fizibilitet puna që bëni ju. Ju bëni një punë shumë të mirë, por jo gjithmonë është e dukshme. Në fakt, kjo krijon edhe konfuzion, se kush merret me këtë, se kush e bën, aq më tepër që janë të përfshira edhe struktura të tjera, prokuroria, gjykata... Kjo nuk del në pah. Ndoshta duhet një mekanizma lobues dhe ndërgjegjësues për punën e institucionit tuaj.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Na nxitët idenë që të fillojmë të gjejmë një mekanizëm, që ta sjellim agjencinë më pranë Komsionit të Sigurisë, edhe me kuadër ligjor, njëkohësisht, të mund të kemi edhe një kontakt me vendin ku ata ushtrojnë veprimtarinë, për ta njohur më së miri, se, në fund të fundit, është shumë i rëndësishëm administrimi i sendeve të sekuestruara dhe të konfiskuara, pra të gjitha aspektet që rrjedhin nga një veprimtari kriminale.

Duhet kuptuar që ky është qëllimi, që ato t'i shkojnë shtetit si përfitim, në rastin kur të gjitha veprimet janë ndjekur rregullisht dhe nuk ka nevojë të bëjmë revokime të masave.

Për ne ka shumë rëndësi edhe statistika në fund, sepse për shkak të natyrës së punës që ndjekim në këtë komision, përballemi me statistika nga Policia e Shtetit, Drejtoria e Pastrimit të Parave, Prokuroria e Përgjithshme. Do të donim të kuptonim diferencën nga njëra tek tjetra, për vete dhe për publikun, si dhe të kishim një statistikë sa më të unifikuar, në kuptimin e aseteve të vërteta kriminale, që rezultojnë të sekuestruara në një vit.

Po, zoti Kala.

Artan Kala – Falënderoj deputeten Gjebrea për pyetjet, aq më tepër, që e njeh shumë mirë punë e agjencisë! Kam pasur fatin të punoj me zonjën Gjebrea kur ishte koordinatore kombëtare antitrafikim.

Kryesisht, ne merremi edhe me mbështetjen e OJF-ve dhe qendrave sociale, për të realizuar edhe synimin e ligjit antimafia, që e kemi pasur deri më sot, për kalimin e këtyre pasurive në shërbim të shtresave në nevojë, siç janë viktimat e trafikimit, por edhe të komuniteteve ku janë marrë këto pasuri. Besoj se në përdorimin social të pasurive jemi mirë.

Për sa i përket strukturës dhe pyetjes që bëri zonja Gjebrea, synojmë që nga 8 punonjës, numri të shkojë në 19, duke përfshirë edhe punonjësit që do të merren me pjesën sociale, sepse ne merremi me sekuestrimin, administrimin, tjetërsimin, si dhe përdorimin social të të gjitha pasurive.

Për *database*-in ndoshta nuk u kuptuam, por unë ju thashë se kemi statistika të sakta për financimin e terrorizimit dhe antimafias, që nga krijimi i agjencisë (të paktën 11 vjet). Vetëm kaq. Pjesën tjetër ne nuk... Përderisa kjo do të vendoste një regjim administrimi, rrjedhimisht do të ketë edhe një statistikë kombëtare. *Database*-i është financuar nga buxheti i shtetit dhe tani po e vëmë në funksion, por kjo nuk na ka penguar të kemi statistika për pjesën që kemi menaxhuar ne, si agjenci.

Pas miratimit të këtij ligji, besoj se koha për strukturën... Është thjesht pjesa e procedurës, sepse eksperiencia e stafit agjencisë është goxha e mirë. Stafi i agjencisë është i përkushtuar dhe i specializuar. Në të gjitha projektet ku jemi përfshirë, kemi synuar ta specializojmë vazhdimisht këtë staf, qoftë me ekspertë italianë, qoftë me projekte të ndryshme të Bashkimit Europian. Ky staf vazhdimisht ka marrë eksperiencën e nevojshme për të realizuar detyrat që ka.

Ju faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Kala!...

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Po, zoti Harusha.

Luan Harusha – Faleminderit, kryetare!

Faleminderit për informacionin!

Çfarë bëhet me mjetet e sekuestruara në komisariate apo pikat e bllokimit kur ka një vendim gjykate?

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Duzha!

Kjo është një pyetje që me gjasë do ta bënin edhe kolegë të tjerë, sepse ky problem është ngritur edhe në vizitat që ne kemi bërë në drejtori të ndryshme të policisë së qarqeve, në Durrës, Fier, Elbasan, Vlorë. Në fakt, ato ndihen shumë në vështirësi për administrimin e tyre, sepse terrenet zihen gjithnjë e më shumë nga mjetet e sekuestruara, aq sa nuk ka vend për parkimin e mjeteve të vetë policisë. Fakti që ju tani do të merrni një atribut për administrimin e një pjese të këtyre gjërave, mendoj që do ta lehtësojë Policinë e Shtetit. Megjithatë, ju keni praktikën tuaj të punës gjatë 11 vjetëve dhe mund ta sqaroni më mirë këtë për të cilën, me të drejtë, ju pyeti zoti Harusha.

Artur Kala – Kjo është një problematikë mjaft e madhe. Në Komitetin e Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar kemi propozuar ngritjen e një komisioni për zgjidhjen e këtyre problematikave. Pavarësisht se këto pasuri, që janë nëpër komisarate, nuk janë në administrimin e agjencisë, synohet kalimi në administrimin e agjencisë (kjo është një nga problematikat që zgjidh ky ligj), shitja paraprake e pasurive ose kalimi në përdorim të institucioneve ligjzbatuese, siç është policia dhe prokuroria.

Vazhdimisht, me pasuritë që kemi në administrim, ne kemi mbështetur Policinë e Shtetit, institucionet ligjzbatuese, duke kaluar automjete dhe pajisje në përdorim të tyre, si dhe duke financuar projekte nga fondet e konfiskimit. Kemi një Komitet të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar, që i rekomandon ministrit përdorimin e të gjitha këtyre. Me ndryshimet në këtë ligj ne synojmë edhe shitjen pas fazës së sekuestros me vendim gjykate. Makina, kompjutera, pajisje IT, ose gjë e gjallë, që të mos rrinë deri në fund të procesit, shiten që në momentin e sekuestros dhe vlera më pas i kalon personit ose buxhetit të shtetit.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Më vjen mirë që ligjin ju nuk e keni punuar vetëm, por keni marrë eksperiencë italiane. Është momenti i duhur për ta bërë, sepse vetë ne kemi konstatuar një pjesë të problemit dhe situata është goxha e rënduar. Besoj se të gjithë ata që janë duke na ndjekur, veçanërisht ata që punojnë në drejtoritë e policisë së qarqeve, do ta mirëpresin këtë masë, sepse do t'i lehtësojë nga një barrë dhe përplasje me njerëzit, të cilëve ju është sekuestruar prona. Nëpërmjet agjencisë suaj, që është e specializuar në administrim, ne synojmë të ruajmë vlerën, e cila, në varësi të mënyrës se si do ta zgjidhë gjykata çështjen, do t'i kalojë buxhetit të shtetit në rast se personi do të shpallet fajtor, ose do t'i kalojë personit në rast se çështja ndaj tij do të pushohet ose ai do të marrë pafajësinë. Fjalën e ka zonja Gjebrea, sepse ka sërish një pyetje. Më pas e ka fjalën zonja Dhima.

Elona Gjebrea – Ngaqë bëni punë të mirë, detyrimisht kemi edhe më shumë pyetje.

Kam dy pyetje të tjera, zoti Artur.

E para ka të bëjë me ekspertët e jashtëm. Si i zgjidhni ekspertët dhe sa është numri i tyre krahasuar me strukturën që ju keni?

E dyta, cilat janë tri institucionet kryesore që kanë përfituar më shumë nga fondet e sekuestruara?

Ermonela Felaj - Po, zoti Kala.

Artur Kala - E falenderoj sërish deputeten Gjebrea! Në fakt, ne kemi staf të brendshëm, me status të nëpunësit civil, dhe të jashtëm, që kontraktohen nga agjencia, të cilët janë administratorët e pasurive dhe ekspertët. Lista e administratorëve i dërgohet gjykatës në mars, e cila zgjedh një nga administratorët dhe cakton pasurinë që sekuestrohet. Ky është personi përgjegjës.

Për sa i përket ekspertëve, rast pas rasti merren ekspertë sipas nevojës për vlerësim që ka agjencia. Pasi del vendimi i ministrit, caktohet një përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe një nga agjencia për të bërë vlerësimin.

Për sa u përket fondeve të sekuestruara, më shumë ka përfituar buxheti i shtetit, kurse nga institucionet ligjzbatuese më shumë ka përfituar Policia e Shtetit dhe agjencia nga administrimi i këtyre pasurive. Kuptohet, edhe prokuroria.

Gjithashtu, kanë përfituar qendrat, si për shembull Qendra e Viktimave të Trafikimit, që është vazhdimisht në fokusin tonë. Besojmë se nga një qendër që vlerësohej e papranueshme për viktimat, sot është qendra më e mirë në Ballkan. Çdo vit japim projekte, i kemi çuar mbi shtatë mijë artikuj. Gjithashtu, kanë përfituar edhe OJF të tjera që kanë objekt të punës së tyre trajtimin e viktimave të trafikimit.

Nxitje e madhe për këtë ka qenë zonja Gjebrea, si koordinatore kombëtare, në kohën që ishte zëvendësministre. Unë e falenderoj, sepse si agjenci sot kemi treguesit më të mirë për përdorimin social dhe mbështetjen e OJF-ve në Ballkan. Pjesa tjetër shkon në buxhetin e shtetit. Fondi i posaçëm krijohet nga agjencia, i dërgohet Komitetit të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar, ku ka përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, përfaqësues të prokurorit të Përgjithshëm, përfaqësues të ministrit të Brendshëm, përfaqësues të gjyqësorit, të ministrit të Financave dhe të agjencisë dhe ky komitet i rekomandon ministrit vendimmarrjen. Besojmë se është një vendimmarrje shumë transparente.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Kam një pyetje që lidhet me pyetjen e zonjës Gjebrea. Ju keni parashikuar aty që fondet mund t'i kalojnë buxhetit të shtetit, një fondi të veçantë për luftën kundër kriminalitetit dhe agjencisë për të përballuar shpenzimet e punës së saj. Ky dallim që ndodh midis buxhetit të shtetit dhe fondit për luftën kundër kriminalitetit, a i lejon buxhetit të shtetit që asete të ndryshme të konfiskuara ose sekuestruara nga aktiviteti kriminal të mund të përdoren për mbrojtjen sociale? Ju thatë që keni ndihmuar viktimat të trafikimit, por ka edhe njerëz që jo domosdoshmërisht janë viktimat të një krimi të caktuar dhe që janë pjesa më vulnerabël. A mundet që, sipas kësaj ndarjeje, komiteti të përcaktojë masat për luftën kundër krimit të organizuar, kurse për fondet e buxhetit të shtetit të mundemi ne si deputetë të përcaktojmë në mënyrë të përgjithshme disa drejtime kryesore ku mund të shkojnë? Asete të krimit janë shtëpi, apartamente, ambiente të ndryshme, që mund të përdoren për njerëz të pastrehë, për fëmijë jetimë. A e lejon ky ligj këtë hapësirë të menduari, që edhe ne, kur të vijmë te diskutimi nën për nen, të jemi më të nxitur për të bërë diçka që shkon si përfitim për publikun?

Artur Kala – Të falenderoj për pyetjen! Në fakt, synimi i agjencisë nuk ka qenë asnjëherë shitja e pasurive, por që këto pasuri të vihen në dispozicion të njerëzve në nevojë për çështje sociale, të viktimave të trafikimit, që janë edhe objekt i ligjit.

Ndërkohë, ne kemi raste, siç është Laguna e Karavastasë, që i ka kaluar Ministrisë së Mjedisit, kemi toka që u kanë kaluar shkollave, sipas kërkesave dhe pushtetit lokal. Falë reformës administrativo-territoriale, sot ne kemi një bashkëpunim shumë të mirë me bashkitë. Besojmë që administrimi më i mirë i këtyre pronave bëhet duke jua kaluar bashkive nëpërmjet dhënies në përdorim apo në pronësi.

Për sa i përket fondit, fondi i posaçëm krijohet nga fondet e konfiskuara dhe të ardhurat që agjencia vjelë nga administrimi i këtyre pasurive. Më pas i dërgohet komitetit dhe komiteti vendos masën e ndarjes mes buxhetit të shtetit, nevojave që ka agjencia dhe financimit të këtyre projekteve ose krijimit të fondit të posaçëm. Te fondi i posaçëm marrin institucionet ligjzbatuese, OJF-të dhe qendrat sociale. Te qendrat sociale kanë marrë edhe qendra të tjera, që kanë objekt jo thjesht viktimat e trafikimit.

Për shembull, ka marrë Qendra e Dhunës ndaj Gruas ose qendra të tjera që merren me probleme sociale që ka komuniteti.

Për sa u përket pasurive, qoftë në këtë ligj, qoftë në ligjin antimafia nuk ka asnjë pengesë që pasuritë të shkojnë për komunitetin. Agjencia nuk e ka pasur kurrë prioritet shitjen, por kalimin në përdorim. Besojmë që ky do të jetë objektivi i agjencisë edhe në vazhdim.

Ermonela Felaj – Ishit i qartë. Faleminderit!

Po, zonja Dhima. Më pas e ka fjalën zoti Sterkaj.

Antoneta Dhima – Kam një pyetje për zotin Kala.

Një pikë shumë e rëndësishme e projektligjit është buxheti, ku ju keni përcaktuar burimet e buxheti për financimin e agjencisë. Midis tyre është edhe pika “burime të tjera të ligjshme”. Çfarë nënkuptoni me këtë fjali? Aktualisht, cilat janë burimet e financimit në institucionin tuaj?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Dhima!

Artur Kala – Të falenderoj për pyetjen!

Për sa i përket burimit të financimit të agjencisë, agjencia funksionon si institucion buxhetor, kurse për administrimin e pasurive ne kemi një buxhet tjetër që vjen nga të ardhurat që ne vjelim nga administrimi i pasurive dhe nga fondet që ndahen nga fondi i posaçëm, që jepet me urdhër të Ministrit të Financave.

Kuptohet, shpenzimet janë të përcaktuara, shpenzime që bën agjencia, vetëm shpenzimet për administrim janë të përcaktuara në VKM.

Po ashtu, është lënë hapësirë për çdo burim tjetër të ligjshëm për fondet që vijnë nga agjencitë, qoftë nga donatorë të huaj, edhe nga pjesë të tjera. Për shembull, tani kemi një projekt prej 350 mijë eurosh financim nga Bashkimi European, ngritjen e tri bizneseve sociale në bashkëpunim me *Partners Albania*. Një biznes është ngritur në Fier dhe po vazhdojmë edhe në Durrës dhe në Sarandë. Pra, synojmë ta shtrijmë këtë projekt. Në përgjithësi janë këto.

Ermonela Felaj – Faleminderit për sqarimin!

Fjalën e ka zoti Sterkaj dhe më pas zonja Xhina.

Paulin Sterkaj – Faleminderit për sqarimin!

Kam një pyetje. Ke ndonjë statistikë sa përqind e pronave të sekuestruara janë konfiskuar?

Artur Kala – Faleminderit!

Kemi statistika të qarta për pjesën e financim-terrorizmit dhe antimafies. Raporti është komplet i zhdrejtë, në të vërtetë. Sasia e sekuestrimeve ndoshta nuk është në trend normal në Shqipëri krahasuar me vendet e tjera të rajonit dhe Ballkanit, sidomos për 2 vjetët e fundit. Në

përgjithësi, rreth 65%-70% e pasurive revokohen nga gjykatat. Ky është një problem që ne si agjenci na ka detyruar të bëjmë ndryshime ligjore. Domethënë, ligji antiamafie, që kemi futur, na bën të mbajmë shpenzimet e administrimit edhe në rast revokimi, që agjencia të mos shpenzohet.

Paulin Sterkaj – Kam edhe një pyetje tjetër.

Mjetet lëvizëse, transportin, në momentin që gjykata i vë në sekuestro, ua jepni institucioneve, i shisni, apo i magazinoni?

Artur Kala – Në përgjithësi, për pasuritë, pas daljes së vendimit të konfiskimit, vazhdojnë procedurat. Afati i agjencisë për të hartuar raportin tekniko-financiar është 90 ditë dhe më pas ia kalojmë komitetit dhe ministrit. Normalisht, në komitet, siç e thashë, janë përfaqësues nga institucionet ligjzbatuese, por edhe përfituese, të cilat, në bazë të kërkesave, pasi çdo pasuri trajtohet aty, mund të kërkojnë që këto mjete të mos shiten, por t'i marrin. Deri më sot kjo bëhet gjithmonë pas vendimit të konfiskimit. Synojmë ta përshpejtojmë në moment sekuestrimin, kuptohet, me vendim gjykate, që të vazhdojmë me tjetërsimin, kalimin në përdorim të institucionit ose edhe për shitje, për të ruajtur vlerën, siç e citova më sipër.

Ermonela Felaj – Dakord.

Nëse nuk ka gjë tjetër nga kolegët, doja të bëja disa pyetje të shpejta me përgjigje të shkurtra.

Ju thatë se keni punuar me asistencë italiane. A mund të themi se ky ligj është i ngjashëm me një ligj italian, apo jo?

Artur Kala – Në fakt, ne kemi modelin italian. Domethënë, ligji antiamafie është pak a shumë i ngjashëm me modelin italian, por edhe praktika apo përdorimi social që ndjek sot agjencia është model italian, sepse është modeli më i suksesshëm i menaxhimit të aseteve kriminale.

Ermonela Felaj – Dakord.

Më vjen mirë, sepse kemi mundësi edhe ta krahasojmë.

E dyta, e gjeni me vend që në ligj nuk flitet shumë për begraundin e njerëzve që do të punojnë në agjenci? Pra, flitet thjesht për numrin e njerëzve që do të ketë agjencia, që do të kenë status të nëpunësit civil, që natyrisht besoj se përzgjedhjen do ta bëjë Departamenti i Administratës Publike, por a mendoni se do të ishte me vend të përcaktohej në mënyrë të përgjithshme begraundi dhe përvoja që do të kenë njerëzit? Për shembull, duhen juristë dhe ekonomistë të këtij niveli, me përvojë, apo e keni marrë të mirëqenë nga fakti që agjencia është ndërkohë e strukturuar dhe ju thjesht po zmadhoni kompetencat dhe numrin e punonjësve tuaj?

Artur Kala – Kriteret përcaktohen nga DAP-i në bashkëpunim me agjencinë, sipas vendeve të punës që ka agjencia, juristë apo ekonomistë.

Pjesa e rekrutimit të stafit do të dalë me një VKM tjetër të ministrit, ku do të përcaktohen kriteret për marrjen në punë, por zakonisht janë kërkesa për juristë dhe ekonomistë, por nuk menduam ta trajtonim në ligj me kriterë, aq më tepër që pjesa e rekrutimeve është kompetencë e DAP-it dhe nuk ...

Ermonela Felaj – E kisha fjalën në kuptimin e përgjithshëm të kriterëve që duhet të plotësojnë.

Artur Kala – Kriteret janë juristë, ekonomistë të ciklit të plotë.

Ermonela Felaj – Kjo ndodh edhe në ligje të tjera, pavarësisht se rekrutimi i tyre do të bëhet nga DAP-i.

E bëra këtë pyetje për t'i paraprirë diskutimit nën për nën nëse kolegët do të kenë ndonjë ide, që të konfigurojnë diçka për këtë pjesë.

Tjetra, për të cilën ju pyeta pak para mbledhjes, do të doja ta kemi të njohur, a është konsultuar ky ligj me Prokurorinë për Krimet e Rënda, me Drejtorinë e Pastrimit të Parave dhe a mund ta kemi në qëndrimin që kanë mbajtur?

Artur Kala – Patjetër që u është dërguar për mendim të gjitha institucioneve, Policisë së Shtetit, Prokurorisë së Përgjithshme, Bankave të Shqipërisë, Drejtorisë së Pastrimit të Parave dhe Ministrisë së Drejtësisë, të cilët na kanë sjellë mendimet ose sugjerimet e tyre për këtë ligj, ku një pjesë e mirë e tyre është pasqyruar me ndryshime në ligj dhe pjesa tjetër, që ne kemi gjykuar se nuk është e drejtë, nuk është pasqyruar.

Ermonela Felaj – E fundit, bëhet fjalë që ju do të administroni sende që lejohen në administrimin civil, apo edhe të tjera?

Ne folëm edhe pak më parë dhe po jua them edhe arsyen pse e bëj këtë pyetje.

Në morinë e punës që ka prokuroria, kushdo qoftë ajo, edhe Prokuroria e Krimeve të Rënda, sekuestron edhe sende që nuk janë të lejuara në qarkullimin civil, për shembull, lëndë të ndryshme ose substanca narkotike, që nuk lejohen as të shiten apo të përdoren përtej përdorimit vetjak, armët, lëndët plasëse, e të tjera që mund të gjejmë rast pas rasti. Do të hyjë agjencia në pjesën e administrimit të tyre? Ju keni thënë në nenin 3: “Ne do të administrojmë edhe pasuritë për të cilat është vendosur masa e sekuestrimit preventiv, sipas kreut 6 të Kodit të Procedurës Penale”. A mos do të ishte rasti për sekuestron konservative, jo për sekuestron preventive? Janë dy sekuestro

të ndryshme. Po lexoj Kodin: “Sekuestro konservative vendoset në rastin kur ka arsye të bazuara për të menduar se nuk ka garanci për pagimin e dënimit me gjobë, të shpenzimeve të procedimit dhe të çdo detyrimi ndaj pasurisë së shtetit, prokurori kërkon sekuestron konservative të pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme të të pandehurit, ose të shumave të sendeve që të tjerët i detyrohen atij në faqet që ligji lejon sekuestrimin e tyre”. Preventivja është krejt tjetër gjë, vjen që në fillim të hetimit, aty ku ai mendon se mund të gjejë gjurmë të kryerjes së veprës penale dhe më pas të provojë kryerjen e veprës penale, e sekuestron, por është sekuestro preventive, sikundër sekuestro është edhe sekuestrimi i mjeteve me të cilën kryhen veprat penale, dhe nuk është e thënë të mos kenë vlerë. Për shembull, automjetet, që rëndom sekuestrohen në të gjitha rastet e shkeljes së qarkullimit rrugor, që është vepër penale, mund të sekuestrohen. Do të hyjnë edhe këto në administrimin tuaj? Pra, dua ta sqarojmë për të gjithë, sepse është pak e vështirë, sepse këto janë mjete që ne mund të gjejmë gjurmë, të cilat u nënshtrohen ekspertimeve, riekspertimeve. Natyrisht, ka një regjim shumë të kufizuar të përdorimit të tyre, sepse çdo hyrje e tretë mund t’i dëmtonte, të pengonte provat. Pra, do të keni të bëni ju me këtë pjesë apo jo? Mos është rasti që aty të thuhet sekuestro konservative dhe jo preventive?

Artur Kala – Ne do ta sqarojmë edhe kur ta diskutojmë nen për nen, por agjencia mendon të administrohen pasuritë e lejueshme në qarkullim. Pjesa e provave pa dyshim që nuk mund të administrohet. Gjykata ka të drejtë t’ia lërë edhe agjencisë, nuk është nevoja për ligj. Ne po synojmë çfarë duam të marrim, të vendosim një regjim. Gjykata edhe mund të na i lërë ato, vendos dhe ne nuk e refuzojmë dot, sepse është vendim gjykate, por ne kemi kërkuar vetëm pasuritë që mund të administrohen. Unë po flas për provat dhe pjesën konservative.

Ermonela Felaj – Dakord.

Do të kemi rast për ta diskutuar.

Sidoqoftë, e çmova ta bëja këtë pyetje për faktin që sendet e kundërligjshme, që nuk lejohen në qarkullim civil, ne i asgjësojmë, ndonëse ato, jo në tregun e përgjithshëm, kanë një vlerë dhe mund të gjendet përdorimi i tyre. Nuk e di nëse është momenti që ne të fusnim një qasje tjetër përmes këtij ligji, por këtë do t’ia lë koleges relatores, ta shikojmë deri në mbledhjen tjetër kur do të bëjmë diskutimin nen për nen.

Besoj se me të gjitha pyetjet e ezauruam kuptimin e ligjit. Jemi të qartë.

Kush është dakord me miratimin në parim të projektligjit “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”? Kundër? Abstenime? Nuk ka.

Faleminderit!

Falënderoj përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe të agjencisë për prezencën e tyre sot!

Falënderoj edhe kolegët për durimin e treguar!

Njëkohësisht, meqenëse nesër është ditë feste, ju uroj gëzuar!

MBYLLET MBLEDHJA